



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

DOSJA E MANIPULUAR E KRYEPROKURORIT TË SHETIT, ALEKSANDËR LUMEZI

**Analizë ligjore e IKD-së rreth trajtimit të rastit të ngritur në publik
rreth dyshimeve për provimin e falsifikuar të jurisprudencës
nga Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi.**

*(Analiza mbështetet në hulumtimin e zhvilluar nga hulumtuesit
e ekipit të emisionit “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavisioni)*

Prishtinë, nëntor 2017

Autorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH PROJEKTIT

Instituti i Kosovës për Drejtësi, po zbaton projektin “Fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë”, i cili ka për qëllim që të forcojë sundimin e ligjit, me qëllim të ngritjes së llogaridhënies dhe transparencës, duke përfshirë gjyqësi të pavarur efikase dhe efektive. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe National Endowment for Democracy (NED).

Qëndrimet e shprehura në raport janë të autorëve. Ato nuk janë domosdoshmërisht edhe qëndrime të donatorëve.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



British Embassy
Pristina



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Nëntor 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	4
II.	Hetimet e kundërligjshme të zhvilluara nga prokuroria jokompetente	7
III.	Prokurori Munishi dhe ngritja e shpejtë në karrierë	9
IV.	Hetimet parapenale të kundërligjshme të prokurorit Munishi	10
V.	Anshmëria e prokurorit në sigurimin e provave dhe dëshmime.....	16
	a). Provat e kundërligjshme, interpretimi i prokurorisë dhe IKD-së	18
	a) Prokurori Munishi injoron provat dhe dëshmitarët e vitit 1999/2000	29
	b) Ekspertiza e dokumenteve jashtë vendit.....	31
VI.	Interpretimi i dëshmime të dëshmitarëve sipas prokurorisë dhe IKD-së	31
	1) Dëshmitari Sahit Shala (dëshmia e parë).....	32
	2) Dëshmitari Sahit Shala (dëshmia e dytë)	33
	3) Dëshmitari Sahit Shala (dëshmia e tretë).....	34
	4) Dëshmitari Radislav Dimitrijevic(dëshmia e parë).....	38
	5) Dëshmitari Radislav Dimitrijevic(dëshmia e dytë)	39
	6) Dëshmitari Radislav Dimitrijevic (dëshmia e tretë)	40
	7) Dëshmitari Miladin Kostic	41
	8) Dëshmitari Zymer Krasniqi	43
	9) Dëshmitari Betim Shala	45
	10) Dëshmitari Riza Smaka	46
	11) Dëshmitari Adil Fetahu	48
	12) Dëshmitari Enver Hasani	49
	13) Dëshmitari Aleksandër Lumezi	50
	14) Dëshmia e Timothy J.Baland	52
	15) Dëshmia e Djorde Aksic	53
VII.	Ndërhyrjet politike dhe paragjykimet në hetimin e dosjes Lumezi	55
VIII.	Monitorimi sipërfaqësor i EULEX-it	56
IX.	Rekomandimet	57

I. Përmbledhje ekzekutive

Dyshimet e ngritura në publik lidhur me falsifikimin e provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit (KSH), Aleksandër Lumezi, në bazë të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë, hyn në kuadër të rasteve të profilit të lartë. Sipas këtij legjislacioni, rastet e profilit të lartë duhet të trajtohen nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), që në rastin konkret nuk ka ndodhur. PSRK gjatë tërë kohës sa janë zhvilluar procedurat në këtë rast ka qëndruar në heshtje të plotë. Një qasje e tillë në publik vë në dyshim pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e kësaj prokurorie. Ky rast i hetuar dhe mbyllur për 21 ditë në mënyrë të kundërligjshme, duhet të hetohet nga PSRK. Ndryshe, ky rast është udhëhequr nga prokurori Kujtim Munishi, njëherësh Shef i Departamentit për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

I gjithë procesi i hetimeve parapenale të prokurorit Kujtim Munishi është i kundërligjshëm. Prokurori Munishi ka filluar të privilegjohej prej ardhjes së Aleksandër Lumezit në krye të Prokurorisë së Shtetit (PSH). Munishi, nga prokurori i shkallës së parë, është avancuar në shkallë të tretë me detyra specifike dhe përgjegjësi të drejtpërdrejta të Kryeprokurorit Lumezi në kuadër të Zyrës së KSH. Gjithë kjo ngritje është bërë në mënyrë të kundërligjshme, pasi Munishi ishte avancuar në kohën kur ishte vetëm me mandat fillestar.

Edhe pse kjo lëndë sipas kompetencave ligjore është dashur të hetohet nga PSRK-ja, Prokurori Kujtim Munishi ka vendosur ta hetojë dosjen e shefit të tij, Kryeprokurorit Lumezi. Por, çdo veprim i ndërmarrë nga Munishi është në kundërshtim me ligjin. Ai ka autorizuar hetuesit e policisë që në procedurë parapenale të grumbullojnë informata, të marrin në pyetje dëshmitarë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, si dhe të sekuestrojnë dosje pa vendim të gjykatës dhe gjithë kjo për një vepër penale, e cila sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë kishte kohë që ka arritur afatin e parashkrimit të ndjekjes penale. Kjo ndalohet me ligj të aplikueshëm në Kosovë, por Munishi ka bërë hetime parapenale për vepër të parashkruar, për të cilin veprim vetë ai duhet të bëhet pjesë e procedurave hetimore disiplinore.

Prokurori Kujtim Munishi, në rastin konkret asnjëherë nuk ka zhvilluar procedurë penale lidhur me dyshimet për falsifikim të dosjes së provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, respektivisht nuk ka ndërmarrë veprime hetimore lidhur me dyshimin e kryerjes së veprës penale të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 434, e cila si të dyshuar të denoncuar publikisht njihte Kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi. Pra, prokurori Munishi, kundërligjshëm ka hetuar një vepër penale të parashkruar, për çka vetë duhet të bëhet subjekt i hetimit, ndërsa ka amnistuar në tërësi çdo mundësi që ta hetojë shefin e tij, Kryeprokurorin Lumezi. Ky i fundit, ishte denoncuar publikisht si i dyshuar për falsifikimin e provimit të jurisprudencës, prandaj prokurori Munishi vërehet qartë se ka bërë amnistinë e shefit, për arsye të cilat vetëm ai mund t'i dijë, por të cilat bien në kundërshtim me ligjin.

Në hetimin parapenal, prokurori Munishi, apriori ka amnistuar dyshimet e ngritura se Aleksandër Lumezi e ka falsifikuar provimin e jurisprudencës. Tërë hetimin e ka bazuar përmes

marrjes së dëshmive të dëshmitarëve në mënyrë të kundërligjshme, tërë hetimi i tij nuk ka pasur asnjë të dyshuar, dhe ka sekuestruar dosje pa urdhër të gjykatës dhe nuk e ka bërë asnjë ekspertizë grafologjike, si dhe ekspertizë tjetër të dokumenteve që do të vërtetonin dyshimet për falsifikim në dokumentet e manipuluar: Mbyllja e rastit është bazuar në tërësi në dëshmitë e ish-zyrtarëve serb të caktuar në pozita në kohën e masave të dhunshme në vitet e 90-ta, pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës, kurse dëshmia e avokatit Betim Shala nuk vërteton asgjë sepse është një supozim, i cili në procedurë penale nuk konsiderohet provë..

Prokurori Munishi nuk ka bërë administrimin e provave të ofruara nga dëshmitari Adil Fetahu. Ai ka qenë anëtar i Komisionit Konsultativ Juridik, i cili e ka intervistuar Aleksandër Lumezin në vitin 2000 kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror. Në procesverbal shkruan se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës. Një tjetër procesverbal i këtij Komisioni, nxjerr në pah se në vitin 2000, ish-Shefi i UNMIK-ut Bernard Kushner, kishte dekretuar 31 kandidatë jashtë propozimeve të Komisionit, kur edhe ishin dekretuar kandidatët pa provim të jurisprudencës, pra që nuk e kishin të dhënë provimin në fjalë. Asnjëra prej këtyre provave që janë procesverbale të vitit 2000 nuk janë administruar nga Prokuroria.

Për më tepër, mbetet e paqartë se si prokurori Munishi është ngutur për mbyllur rastin pa sigurimin e dosjeve të UNMIK-ut dhe OSBE-së, të cilat do të mund të qartësonin nëse Aleksandër Lumezi ka pasur provim të jurisprudencës në vitin 2000, si dhe nëse Aleksandër Lumezi është njëri nga 31 kandidatët e dekretuar pa provim të jurisprudencës apo nëse e ka pasur atë në atë kohë kritike. Kjo në praktikën gjyqësore është e paparë ndonjëherë, duke lënë hapësirë për të ngritur dyshime se qëllimi në këtë rast ka qenë mbyllja e shpejtë e rastit dhe jo zbardhja e së vërtetës.

Në këtë proces hetimor parapenal Munishi nuk ka pasur asnjë person të dyshuar, por vetëm dëshmitarë. Në Kosovë në cilësinë e dëshmitarit janë marrë në pyetje: Sahit Shala, Radislav Dimitrijevic, Aleksandër Lumezi, Riza Smaka, Adil Fetahu, Enver Hasani, Betim Shala dhe Zymer Krasniqi.

Ndërsa, pa pasur vendim për fillim të hetimeve dhe kundërshtim me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar ka marrë prova dhe dëshmitarë jashtë rrugës zyrtare ligjore. Në këtë drejtim, ka marrë si provë një akt të noterizuar të Djordje Aksic, i cili figuron si ish-anëtar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës në vitin 1991 dhe si ish-Sekretar Krahinor në kohën e masave të dhunshme në Kosovë. Ndërsa, ka marrë në pyetje Miladin Kostic, gjithashtu ish-anëtar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës në vitin 1991.

Asnjë prej këtyre dëshmive nuk vërteton dhënien e provimit të jurisprudencës, përderisa në tërësi dosja është e manipuluar me llak të bardhë, mbi dosjen e Zymer Krasniqit dhe nuk ka një ekspertizë grafologjike (dhe ekspertizë tjetër relevante) për të.

Dyshimet e ngritura në publik se Aleksandër Lumezi e të falsifikuar provimin e jurisprudencës dhe proces i hetimeve parapenale të zhvilluara nga prokurori Kujtim Munishi është përshkuar me paragjykitime dhe ndërhyrje nga politika, qeveria dhe vetë sistemi prokurorial. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë disa deklaratata, duke i paragjykuar hetimet e prokurorisë, se ato, do të përfundojnë për një kohë të shkurtër. Kjo përbën ndërhyrje të politikës dhe të

ekzekutivit të vendit mbi sistemin prokurorial dhe hetimet që ishin duke u zhvilluar në këtë rast.

Në anën tjetër, Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka paragjykuar në tërësi çdo dyshim të ngritur rreth dosjes së falsifikuar të provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezit, duke kërkuar tërheqjen e akuzave dhe shkrimeve për këtë temë. Njëjtë i kanë dalë në mbrojtje eprorit të tyre edhe Shoqata e Prokurorëve të Kosovës (SHPK), e cila ka paragjykuar në tërësi pretendimet e ngritura rreth provimit të jurisprudencës së Lumezit.

Ky rast thuhet se është monitoruar nga EULEX-i, i cili ka deklaruar se prokurorja e EULEX-it, Eëa Korpi, e cila ka monitoruar rastin, është shprehur e kënaqur me hetimin e pavarur dhe të paanshëm. Por, Misioni i EULEX-it, nuk deklarohet nëse ky është edhe qëndrim zyrtar i këtij misioni, apo vetëm qëndrim dhe opinion i prokurores Korpi. Përveç kësaj, shumica e dëshmitarëve të intervistuar kanë deklaruar se gjatë marrjes në pyetje nuk kanë pasur përkthim në gjuhën angleze dhe se këtë rol kohë pas kohe e kishte luajtur vetë prokurori Munishi.

Hetimi i deritashëm në procedurë penale rezulton të jetë i pavlefshëm, *nul*. Në këtë drejtim, me qëllim të zbardhjes të së vërtetës dhe zhvillimit të një procesi hetimor të pavarur, të paanshëm, të drejtë dhe profesional, rekomandohet që në pajtim me obligimet kushtetuese dhe ligjore këto dyshime të ngritura në publik të hetohen nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRKS). Të gjitha kushtet ligjore për hetimin e këtij rasti nga EULEX-i janë të plotësuara dhe rekomandohet që hetimi të zhvillohet përmes krijimit të një ekipi të prokurorëve të EULEX-it me prokurorë amerikanë, britanikë dhe gjermanë.

IKD rekomandon që PSRK-ja të kërkojë ekspertizë të të gjitha dokumenteve të manipuluar me llak dhe të tjera që dyshohet se janë falsifikuar. KPK-ja deri në zbardhjen e këtij rasti, në pajtim me ligjin e aplikueshëm, duhet të marrë masa lidhur me suspendimin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, ndërsa PSRK-ja dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor duhet të analizojnë aktvendimin për hedhjen e kallëzimit penal nga prokurori Munishi, dhe të hetojnë nëse gjatë trajtimit të këtij rasti është zbatuar ligji dhe procedurat sipas legjislacionit në fuqi.

II. Hetimet e kundërligjshme të zhvilluara nga prokuroria jokompetente

Dosja e provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezit doli në pah më 18 tetor 2017, në ditën kur u dënua me një vit burgim me kusht ish-rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, për veprën penale të mashtrimit në detyrë. Pak orë para pas shpalljes së aktgjykimit, Hasani përmes adresës elektronike, akuzoi publikisht Kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi, se i njëjti e ka të falsifikuar provimin e jurisprudencës. Këtë akuzë pretendonte se e kishte mbështetur në një hulumtim, të cilin ai vetë e kishte bërë në muajin prill 2017 në dosjen e jurisprudencës së Lumezit në Arkivin e Kosovës.

Shefi i Departamentit të Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, prokurori Kujtim Munishi, njëherësh anëtar i Komisionit¹ për përcjelljen e ditore të mediave dhe verifikim të pretendimeve të raporteve për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, kishte autorizuar Policinë e Kosovës për mbledhjen e informatave lidhur me dyshimin se është kryer vepra penale “falsifikimi i dokumentit zyrtar” nga neni 434, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Në bazë të analizës ligjore të aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal nga prokurori Munishi, që është objekt analize i këtij raporti, del se të gjitha veprimet e ndërmarra nga prokurori Munishi në drejtim të hetimit të kësaj vepre penale janë në kundërshtim me ligjin, për shkak se vepra penale e hetuar e ka arritur afatin e parashkrimit të ndjekjes penale. Gjithashtu sipas legjislacionit të aplikueshëm dhe praktikës së ndërtuar prej vitit 2013, rezulton se Prokuroria Themelore e Prishtinës nuk ka pasur kompetencë të bëjë hetimin dhe ndjekjen e profilit të lartë, por vetëm PSRKS. Rrjedhimisht, dyshimet e ngritura nga Enver Hasani se Aleksandër Lumezi e ka falsifikuar provimin e jurisprudencës, i cili tash ushtron pozitën e KSH, i takojnë profilit të lartë sepse një gjë e tillë është përcaktuar shumë qartë në Udhëzimin Administrativ të nxjerrë nga KSH, Kryeprokurori i PSRK-së dhe Kryeprokurori i EULEX-it. Sipas këtij udhëzimi, profilet e larta, ku hyn edhe Kryeprokurori i Shtetit, hetohen dhe ndiqen nga PSRK-ja.

Një gjë e tillë nuk ka ndodhur, për shkak se prokurori Kujtim Munishi, hetimin parapenal, të cilin e ka zhvilluar, e ka kufizuar ekskluzivisht në veprën penale “falsifikimi i dokumentit zyrtar” nga neni 434, paragrafi 1 të Kodit Penal, e cila ka mund të kryhet vetëm nga personat përgjegjës që kanë qenë të autorizuar si persona zyrtarë në Sekretariatit Krahinor të Judikaturës së Kosovës.

Prokurori Munishi nuk ka autorizuar hetime edhe lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës penale së përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 434 të KPK², ku si i dyshuar në publik ka qenë

¹Shënim: Me Vendimin të Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, A.nr.208/2015 të datës 17 qershor 2015, ishte themeluar Komisioni për monitorimin dhe përcjelljen ditore dhe verifikimin e pretendimeve të rasteve të supozuara të krimit të organizuar e të korrupsionit, të publikuara përmes mjeteve elektronike e të shtypit, të parashtresave të qytetarëve dhe paraqitjeve publike të zyrtarëve të organeve e organizatave shtetërore e publike dhe të organizatave joqeveritare.

² Paragrafi 2 i nenit 434 të Kodit Penal të Kosovës përcakton se “Personi zyrtar i cili shfrytëzon dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare të rreme si të vërtetë në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh,

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, hetim ky, i cili është dashur të zhvillohet vetëm nga PSRK. Rrjedhimisht, objekt i hetimit do të ishte ligjshmëria e marrjes së certifikatës së provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezi. Këto dy rrethana, mungesa e subjektit të dyshuar dhe e objektit të hetimit (*verifikimi i ligjshmërisë së marrjes së provimit të jurisprudencës*) e bëjnë tërë këtë hetim të pavlefshëm ligjërisht dhe në tërësi fiktiv, i kryer me shpejtësi, duke injoruar provat dhe dëshmitë relevante që do të zbardhnin realitetin e këtij rasti.

IKD vlerëson se veprimet e ndërmarra nga prokurori Kujtim Munishi për hetimin e dosjes së manipuluar të Aleksandër Lumezit në secilën fazë janë të kundërligjshme, pasi ka bërë hetim parapenal për një vepër të parashkruar penale, e cila ndalohet me ligj dhe si të tilla të gjitha veprimet dhe vendimet e Munishit nuk kanë vlerë juridike dhe në drejtësinë penale konsiderohen *nul*, përkatësisht në tërësi të pavlefshme duke e lënë rastin në fjalë të hapur për hetim real penal në tërësinë e tij. Veprimet e ndërmarra nga prokurori Munishi kanë cënuar rëndë sigurinë juridike, respektivisht kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (KEDNJ), parimet bazë të garantuara me KP dhe Kodin e Procedurës Penale (KPP), të personave të thirrur si dëshmitarë.

Në një shtet demokratik dhe ligjor, ku sundon ligji në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, dhe ku kultura e pandëshkueshmërisë nuk gjen zbatim në praktikë, veprimet e kundërligjshme të prokurorit do të ishin subjekt i mekanizmave të llogaridhënies, si në aspektin dicitplinor ashtu edhe në atë penal.

Përndryshe, ky hetim parapenal i kundërligjshëm është zhvilluar nga prokurori Kujtim Munishi, i cili në afat rekord, sipas tij, ka arritur t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale për të vendosur në rastin e dosjes së shefit të tij, Aleksandër Lumezi. Ky proces i hetimeve parapenale në letra, por me synim dhe qëllim që të shërbej si një proces real penal përmes veprimeve të ndërmarra, ka përfunduar për vetëm 21 ditë dhe në fund prokurori Munishi ka vendosur të konstatoj me aktvendim se, pas analizimit të shkresave të lëndës, provave materiale, dëgjimit të dëshmitarëve, dosja e provimit të jurisprudencës e shefit të tij, Aleksandër Lumezi, e cila dyshohej se mund të jetë e manipuluar dhe falsifikuar, me asnjë provë nuk është vërtetuar si e tillë.

Përveç këtij defekti material (*substancial*) që lidhet me mënyrën e kryerjes së hetimeve parapenale, subjektit dhe objektit (*ligjshmërisë së certifikatës së jurisprudencës së Aleksandër Lumezit*) të cilët nuk kanë ekzistuar gjatë tërë kohës së hetimeve parapenale të zhvilluara, ky hetim ka edhe një veçanti që lidhet me cilësitë (statusin) e personit që e ka kryer hetimin, pra me prokurorin Kujtim Munishi.

dëmtton apo në ndonjë mënyrë tjetër e 156 bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni."Kodit Penal i Republikës së Kosovës.

III. Prokurori Munishi dhe ngritja e shpejtë në karrierë

Hetimet për dyshimet mbi falsifikimin e provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezit janë zhvilluar nga vartësi i tij, prokurori Kujtim Munishi. Ky i fundit, për një kohë të shkurtër, ka arritur të punojë në pozita të rëndësishme në sistemin prokurorial. Ai ka filluar punën si prokuror më 28 dhjetor 2012. Në gusht të vitit 2013 ka shkuar në SHBA, në një shkollim 1 vjeçar, të organizuar nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë. Pas shkollimit, ka punuar disa muaj në Prokurorinë Themelore në Gjilan, për të vazhduar më pas ngritjen e shpejtë në karrierë. Pas dy vite e gjysmë përvojë si prokuror i Gjilanit, Munishi ishte avancuar në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, me detyra specifike, nën urdhrat e drejtpërdrejta të Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi. Kryeprokurori i Shtetit, përmes një vendimi të kundërligjshëm të datës 28 prill 2015, ka përcaktuar se Kujtim Munishit, prokuror në Prokurorinë Themelore në Gjilan, i delegohen kompetencat në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 109 (5) i Kushtetutës së Kosovës, përcakton se mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.

Prokurori Munishi, gjatë periudhës së tij si prokuror me mandat fillestar, në bazë të Kushtetutës, Ligjit dhe rregulloreve të miratuara nga KPK do të duhej të tregonte rezultate si prokuror i shtetit në ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale dhe të dëshmonte se ishte i denjë dhe profesional si prokuror i shtetit për të bindur Komisionin për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve dhe KPK për të marrë vlerësim pozitiv lidhur me ri-emërimin e tij si prokuror i shtetit me mandat të përhershëm.

Privilegjet e Prokurorit Munishi fillojnë menjëherë pas emërimit të Aleksandër Lumezit si Kryeprokuror i Shtetit në mesin e muajit prill të vitit 2015 dhe në të njëjtën kohë edhe Kryesues i KPK , gjatë kohës sa Prokurori Munishi ka qenë me mandat fillestar.

Prokurori Munishi gjatë kohës sa ka qenë prokuror me mandat fillestar, përfiton nga një vendim i kundërligjshëm i Kryeprokurorit Lumezi, i cili bazuar në Ligjin për Prokurorinë e Shtetit të vitit 2010, i cili ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit, e që është data 28 prill 2015, neni 20, pika 1.4., i cili qartëson se për të ushtruar funksionin e prokurorit pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kandidati duhet të ketë së paku gjashtë vjet përvojë juridike në të drejtën penale, përfshirë së paku katër vjet përvojë si prokuror.

Sidoqoftë, pika dy e vendimit të Kryeprokurorit Lumezi, thotë se përveç kompetencave që Munishi do t'i kishte si prokuror i Gjilanit, ai do të ushtrojë edhe funksione të tjera që hyjnë në kuadër të zyrës së KSH, duke përfshirë: hartimin e raporteve dhe dokumenteve të tjera me shkrim.

Pika tre e këtij vendimi, thotë se prokurori Munishi do të kryejë edhe detyra dhe përgjegjësi tjera shtesë të caktuara nga Kryeprokurori i Shtetit.

Pika katër e këtij vendimi, thotë se prokurori Munishi do të ushtrojë kompetenca dhe përgjegjësi nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryeprokurorit të Shtetit.

Pika pesëe këtij vendimi, thotë se Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit obligohet të ndajë një zyrë dhe të ofrojë kushte adekuate për punë për prokurorin Munishi.

Pika gjashtëe këtij vendimi, thotë se prokurori Munishi do të përfitojë të drejtat sikurse prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, përveç pagës e cila do të vazhdojë të paguhet sipas dekretit për emërim.

Tutje, sipas vetë deklarimit të Munishit në media, ai me vendim të Këshillit Prokurorial të Kosovës prej 25 majitka filluar punën si këshilltar në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit deri më 30 shtator 2016.

Kryeprokurori Lumezi prej dekretimit të tij deri më 1 janar 2016, ishte edhe kryesues i KPK-së.

Prokurori Munishi në mbledhjen e 30 majit 2017 të KPK-së ishte zgjedhur shef në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prishtinë.

Prokurori Munishi edhe përkundër faktit se me këtë vendim të Kryeprokurorit Lumezi ishte caktuar në mënyrë të kundërligjshme në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, në një prononcim publik kishte deklaruar se asnjëherë nuk ka qenë këshilltar i Kryeprokurorit Lumezi, dhe se gjatë kohës sa ka punuar si këshilltar në Zyrën e Koordinatorit për luftimin e Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit, ka qenë edhe raportues për Integritet Evropian nga Prokuroria e Shtetit.

Prokurori Munishi me vendim të Kryeprokurorit Lumezi, ishte caktuar si anëtar i komisionit për përcjelljen ditore dhe verifikimin e rasteve të supozuara të krimin të organizuar e të korrupsionit të transmetuara në media.

Në vazhdim paraqitet analiza e anës materiale (*substanciale*) të defekteve të gjithë procesit për përshkuar të hetimeve të kryera nga prokurori Kujtim Munishi.

IV. Hetimet parapenale të kundërligjshme të prokurorit Munishi

Sipas Aktvendimit me nr. PPN-202/17 të datës 14 nëntor 2017 mbi hedhjen e kallëzimit penal, lidhur me dyshimet mbi manipulimin e dosjes së provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, trajtimi i kësaj çështje nga Prokuroria Themelore në Prishtinë është bërë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, respektivisht në kundërshtim me KP dhe KPP të të Republikës Kosovës.

Prokurori Munishi në kundërshtim me ligjin ka kërkuar nga Policia e Kosovës që në procedurë parapenale të grumbulloj informata, të marrë në pyetje dëshmitarë dhe të sekuestrojë dosje lidhur me një vepër penale, e cila sipas ligjit kishte arritur afatin e parashkrimit të ndjekjes penale.

Në bazë të KP, në çdo fazë të procedurës penale, gjykata dhe organet e tjera të ndjekjes penale janë të detyruara sipas detyrës zyrtare të kujdesen, ta marrin parasysh dhe ta zbatojnë parashkrimin. Së këndejmi, parashkrimi shprehet sipas fuqisë së ligjit (*ex lege*), në të gjitha rastet kur skadojnë afatet e parashkrimit.

Sipas KPP, Policia detyrohet të veprojë vetëm sipas kërkesave të ligjshme të prokurorit. Policia e Kosovës në këtë rast ka vepruar sipas autorizimeve të kundërligjshme të Prokurorit Munishi.

Në rastin konkret, Prokuroria asnjëherë nuk ka zhvilluar procedurë penale lidhur me dyshimet për falsifikim të dosjes së provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit, respektivisht nuk ka ndërmarrë veprime hetimore lidhur me dyshimin e kryerjes së veprës penale të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 434 nga Kryeprokurori Lumezi, siç ishte ngritur në denoncimin publik (*ligjshmëria e fitimit të certifikatës për dhënien e provimit të jurisprudencës nga ana e Kryeprokurorit të Shtetit Aleksandër Lumezi*).

Prokurori Munishi i monitoruar nga prokurori i EULEX-it, edhe përkundër faktit se ka zhvilluar procedurë parapenale, në të njëjtën kohë dhe në kundërshtim me dispozitat e KPP ka marrë në pyetje dëshmitarë nga Kosova dhe Serbia, ka sekuestruar dosje në Arkivin e Kosovës dhe në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës. Sekuestrimi sipas aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal është bërë pa urdhër të gjykatës. Sekuestrimi është kryer në mënyrë të kundërligjshme, duke bërë që provat e mbledhura të jenë të papranueshme në cilëndo fazë të mëvonshme në gjykatë.

Prokurori Munishi, ende pa filluar procedurën lidhur me këtë rast, i ka orientuar Policinë e Kosovës në grumbullimin e informatave vetëm sa i përket veprës penale që sipas ligjit ka qenë e parashkruar.

Edhe përkundër faktit se në denoncimin publik lidhur me dosjen e falsifikuar të Kryeprokurorit Lumezi, janë ngritur dyshime nga Enver Hasani se Kryeprokurori Lumezi ka provimin e jurisprudencës së falsifikuar, Prokurori Munishi me asnjë veprim nuk e ka orientuar hetimet lidhur me këtë çështje.

Neni 434 i KP ka dy paragrafë. Paragrafi 1-rë i kësaj veprë penale ka mund të kryhet vetëm nga personat zyrtarë që kanë punuar në Sekretariatit Krahinor të Judikaturës, veprë kjo penale e parashkruar dhe e cila është hetuar nga Prokurori Munishi. Paragrafi 2-të i nenit 434 ka mund të kryhet vetëm nga personi zyrtar që duke shfrytëzuar një dokument të falsifikuar realizon të drejta të caktuara, veprë penale kjo që në bazë të nenit 434 paragrafi 2 nuk është e parashkruar, por që në praktikë asnjëherë nuk është hetuar nga Prokurori Munishi në bazë të analizës së aktvendimit të larëcekur për hedhjen e kallëzimit penal.

Mënyra se si është udhëhequr ky rast, në publik ngritë shumë dyshime dhe pikëpyetje, të cilave Prokurori Munishi nuk u ka dhënë përgjigje. Praktika gjyqësore dëshmon se në raste të tilla, kur dyshohet për dokumente të falsifikuara, përveç dëshmimeve, procesverbaleve, rol vendimtar në zbardhjen e së vërtetës luan ekspertiza e dokumenteve të dyshuara si të manipuluar. Prokurori këtë obligim ligjor e ka injoruar tërësisht, duke paragjykuar rastin. I njëjti asnjëherë nuk ka kërkuar ekspertizë lidhur me dyshimet për dosjet e manipuluar.

Prokurori Munishi në aktvendim shkruan se kanë paraqitur kërkesa për qasje në dokumentet lidhur me emërimin e prokurorëve dhe gjykatësve në UNMIK dhe OSBE. I njëjti, pa pranuar asnjë përgjigje, ka nxjerrë aktvendimin e lartëcekur për hedhjen e kallëzimit penal. Kjo në praktikën gjyqësore është e paparë ndonjëherë, duke lënë hapësirë për të ngritur dyshime se qëllimi në këtë rast ka qenë mbyllja e shpejtë e rastit dhe jo zbardhja e së vërtetës.

Katër prej dëshmitarëve të gjallë të Komisionit Konsultativ Juridik (Komisioni), të cilët kishin vlerësuar kandidatët për gjykatës dhe prokurorë në vitin 1999/2000, deklarojnë se konfirmojnë në tërësi vërtetësinë e procesverbaleve, sipas të cilave Aleksandër Lumezi nuk ka pasur provim të jurisprudencës në atë kohë. Për më tepër, sipas këtyre procesverbaleve, ish-Kryeadministratori i UNMIK-ut Bernard Kushner, kishte dekretuar 31 kandidatë në kundërshtim me ligjin, përfshirë kandidatët pa provim të jurisprudencës. Prokurori Munishi nuk ka marrë mundin që të presë përgjigjet e UNMIK-ut dhe OSBE-së për sigurimin e këtyre dosjeve për të zbardhur të vërtetën përtej çdo dyshimi.

Prokurori Munishi rëndësi kyçe iu ka dhënë dëshmive të zyrtarëve serbë, të cilët gjatë viteve të nëntëdhjeta ishin emëruar përmes masave të dhunshme të instaluar nga aparati shtetëror jugosllav.

Në vazhdim në kronologji janë paraqitur të gjitha veprimet e kundërligjshme të prokurorit Kujtim Munishi të kryera gjatë hetimit të dosjes Lumezi. Kjo kronologji përfshinë :

1. Përshkrimin e veprimeve kryesore të ndërmarra gjatë trajtimit të rastit

2. Shkeljet ligjore dhe procedurale;

3. Hetimet e kufizuara nga Prokurori Munishi; dhe,

4. Sekuestrimi i dosjeve në kundërshtim me ligj:

1. Përshkrimin e veprimeve kryesore të ndërmarra gjatë trajtimit të rastit nga Prokurori Kujtim Munishi:

1. Sipas Aktvendimit me nr. PPN-202/17 të datës 14 nëntor 2017, mbi hedhjen e kallëzimit penal, Prokurori Kujtim Munishi më 25 tetor 2017, ka autorizuar Policinë e Kosovës, për mbledhjen e informatave të nevojshme lidhur me dyshimin së është kryer vepra penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar”, neni 434, paragrafi 1, veprë penale kjo e parashkruar sipas ligjit.
2. Prokurorit Munishi i janë nevojitur vetëm 21 ditë për të vendosur lidhur me këtë çështje nga koha e ka autorizuar Policinë për mbledhjen e informatave deri në kohën kur është marrë aktvendimi për hedhjen e kallëzimit penal.
3. Sipas autorizimit të Prokurorit Munishi, Policia e Kosovës më 25 tetor 2017, në Arkivin e Kosovës, ka sekuestruar dosjen e provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi. Më 26 tetor 2017, në Ministrinë e Drejtësisë ka sekuestruar edhe librat e dhënies së provimit të jurisprudencës për periudhën kohore 1986-1992.
4. Sekuestrimi është bërë pa urdhër të gjykatës. Sekuestrimi është kryer në mënyrë të kundërligjshme, duke bërë që provat e mbledhura të jenë të papranueshme në gjykatë.

2. Shkeljet ligjore dhe procedurale të evidentuara gjatë trajtimit të rastit nga Prokurori Kujtim Munishi:

1. Sipas aktvendimit si më sipër mbi hedhjen e kallëzimit penal, Prokurori Munishi, hetimin e ka orientuar vetëm sa i përket dyshimeve për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar” nga neni 434, paragrafi 1 i KP të Kosovës.³
2. Duke u bazuar në elaborimin më lartë, konsumimi i veprës penale sipas paragrafit 1 të nenit 434 të KP të Kosovës, mund të kryhet vetëm nga personat përgjegjës që kanë qenë të autorizuar si persona zyrtarë në Sekretariatit Krahinor të Judikaturës.
3. Kryerësi apo kryerësit potencialë të kësaj vepre penale sipas Kodit Penal aktual dënohen *me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*”
4. Të gjitha veprimet e Prokurorit Munishi dhe të Policisë së Kosovës, sipas autorizimeve të dhëna nga Prokurori Munishi, janë ndërmarrë në kundërshtim me KP të Kosovës, pasi në rastin konkret ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale lidhur me hetimet e autorizuar nga Prokurori Kujtim Munishi.⁴
5. Në bazë të KP të Kosovës, në çdo fazë të procedurës penale, gjykata dhe organet e tjera të ndjekjes penale si dhe organet e ekzekutimit të sanksioneve penale, janë të detyruara, sipas detyrës zyrtare, të kujdesen, ta marrin parasysh dhe ta zbatojnë parashkrimin. Së këndejmi parashkrimi shprehet sipas fuqisë së ligjit (*ex lege*), në të gjitha rastet kur skadojnë afatet e parashkrimit.
6. Koha që duhet të kalojë për t’u bërë parashkrimi, quhet afati i parashkrimit. Kohëzgjatja e afatit të parashkrimit është i përcaktuar varësisht prej lartësisë së dënimit të paraparë për veprën penale.
7. Kodi Penal ka përcaktuar parashkrimin e ndjekjes penale, nëse kalojnë dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim; apopesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim.
8. Nëse dyshimet e ngritura janë se manipulimi i dosjes është kryer në vitin 1991, kanë kaluar mbi 26 vjet nga dyshimet për kryerjen e veprës penale;
9. Nëse dyshimet e ngritura janë se manipulimi i dosjes është kryer në vitin 1999 apo 2000, kanë kaluar mbi 16 vjet nga dyshimet për kryerjen e veprës penale.
10. Në secilin variant, Prokurori Munishi ka autorizuar hetime lidhur me një vepër penale e cila tashmë ka qenë e parashkruar.

³Sipas paragrafit 1 të këtij neni, vepra penale ekziston kur personi zyrtar, në dokumentin zyrtar a afarist, në regjistër apo shkresë shënon të dhëna të rreme ose nuk i shënon të dhënat e rëndësishme, ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën që përmban të dhëna të rreme, ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin po shkresës së tillë me përmbajtje të rreme. Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

⁴Parashkrimi i ndjekjes penale konsiston në atë se për shkak të kalimit të afatit i cili është paraparë me ligj nuk mund të ndërmerret ndjekja penale dhe personit nuk mund t’i shqiptohet dënimi për vepër penale që e ka kryer. Nëse ndjekja penale është në vazhdim e sipër dhe nëse në ndërkohë ka ardhur gjer te parashkrimi, ndjekja penale nuk mund të vazhdohet. Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

11. Sipas nenit 82 të KPP të Kosovës, Prokurori i Shtetit, ndër të tjera, me aktvendim e hedh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale.
12. Edhe me gjithë obligimin ligjor të përcaktuar me këtë nen të Kodit, Prokurori Munishi dhe Policia e Kosovës, kanë grumbulluar informata, kanë sekuestruar materiale dhe kanë marrë në pyetje dëshmitarë, në kundërshtim me ligj.
13. Sipas nenit 83 të KPP të Kosovës, Policia detyrohet të veprojë vetëm sipas kërkesave të ligjshme të prokurorit.
14. Policia e Kosovës ka vepruar sipas autorizimeve të kundërligjshme të Prokurorit Munishi.

3. Hetimet e kufizuara nga Prokurori Munishi:

1. Në bazë të aktvendimit, të nënshkruar nga vetë Prokurori Kujtim Munishi, i njëjti hetimet i ka kufizuar vetëm sa i përket paragrafit 1 të nenit 434 të KP të Kosovës.
2. Prokurori Munishi nuk ka autorizuar hetime edhe lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës penale së përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 434 të KP të Kosovës⁵, ku si i dyshuar në publik ka qenë Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi.
3. Vepra penale e parashikuar nga paragrafi 2 ekziston kur personi zyrtar a personi përgjegjës në veprimtarinë e tij afariste shfrytëzon dokumentin e rremë zyrtar apo afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën zyrtare, si të ishin të vërteta, ose asgjëson, fsheh, dëmton apo bën të papërdorshëm në çfarëdo mënyre tjetër dokumentin zyrtar ose afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën zyrtare.
4. Kjo vërtetohet se Prokurori Kujtim Munishi asnjëherë nuk ka iniciuar hetime kundër Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, respektivisht nuk ka ndërmarrë veprime hetimore lidhur me dyshimin e kryerjes së veprës penale të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 434, nga Kryeprokurori Lumezi.
5. Prokurori Munishi, ende pa filluar procedurën lidhur me këtë rast, e ka orientuar Policinë e Kosovës në grumbullimin e informatave vetëm sa i përket veprës penale që sipas ligjit ka qenë e parashkruar.
6. Prokurori Munishi nuk ka nxjerrë një aktvendim për fillimin e hetimeve. Tërë procedura e udhëhequr nga prokurori Munishi në këtë rast i takon procedurës parapenale.
7. Edhe pse Prokurori Munishi, nuk ka marrë vendim për fillim të hetimeve, ai ka marrë në pyetje një numër të dëshmitarëve, ka sekuestruar dosje, dokumente nga Arkivi i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë në kundërshtim me ligjin.
8. Me këto veprime Prokurori Munishi, ka shkelur dispozitat e KPP, ka shkelur të drejtat dhe liritë e personave që janë thirrur si dëshmitarë, dhe ka cenuar rëndë sigurinë e tyre juridike.
9. Sipas nenit 6 të KPP, procedura penale fillohet vetëm me vendim të Prokurorit të Shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer veprë penale.

⁵ Paragrafi 2 i nenit 434 të KP përcakton se “Personi zyrtar i cili shfrytëzon dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare të rreme si të vërtetë në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh, dëmton apo në ndonjë mënyrë tjetër e 156 bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.” Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

10. Sipas nenit 7 të KPP, gjykata, Prokurori i Shtetit dhe Policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale, detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet, të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.
11. Edhe me gjithë faktin se dyshimet e ngritura në publik janë ndërlidhur me dyshimin për falsifikimin e provimit të Kryeprokurorit të Shtetit, prokurori Munishi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me zbardhjen e së vërtetës.
12. Gjatë tërë trajtimit të këtij rasti, Prokurori Munishi, në bazë të aktvendimit të sipercekur për hedhjen e kallëzimit penal, figuron se ai nuk ka pasur asnjë të dyshuar.
13. Neni 136 i KPP, mundëson ekspertimin. Përmes ekspertimit, do të mundësohej që të bëhej ekspertiza e dokumenteve dhe dosjes së manipuluar të Kryeprokurorit të Shtetit.
14. Për këtë qëllim do të duhej të caktohej eksperti i fushës kompetente me përvojë ose me trajnim të specializuar që është relevant dhe aktual.
15. Eksperti do duhej t'i ketë analizuar provat e siguruara (dosjet).
16. Gjatë ekspertizës, eksperti duhet të ketë përdorur praktika përgjithësisht të pranura në fushën e tij ose të ketë bazë shkencore apo teknike.
17. Eksperti do të duhej të hartonte një raport, në të cilin përmbledohen metodat e përdorura të analizës dhe përfundimet.
18. Asnjë nga këto mundësi që i përcakton KPP, prokurori Munishi nuk i ka shfrytëzuar.
19. Asnjë nga dokumentet e sekuestruara nga Prokurori Munishi, pa urdhër të gjykatës, nuk kanë qenë pjesë e ekspertizës.
20. Rasti që është trajtuar nga Prokurori Munishi i takon viteve të largëta, 1990,1991 deri në vitin 2000.
21. Praktika gjyqësore dëshmon se në raste të tilla, përveç dëshmive, procesverbaleve, rol vendimtar në zbardhjen e së vërtetës luan ekspertiza e dokumenteve të dyshuara si të manipuluar.
22. Prokurori këtë obligim ligjor e ka injoruar tërësisht, duke e paragjykuar rastin.
23. Prokurori Munishi rëndësi kyç iu ka dhënë dëshmive të zyrtarëve serbë, të cilët gjatë viteve të nëntëdhjeta ishin instaluar nëpërmjet masave të dhunshme të aparatit shtetëror serb, përkatësisht jugosllav.
24. Deklarata e noterizuar e Gjorgje Aksiqit nuk ka dëshmuar asgjë më shumë sesa nënshkrimin e tij mbi një dokument, i cili i është prezantuar atij në Beograd të Serbisë. Ai nuk ka marrë asnjë përgjegjësi për origjinalitetin e dokumentit, por vetëm e ka vërtetuar se nënshkrimi mbi dokumentin e prezantuar i takon atij.

4. Sekuestrimi i dosjeve në kundërshtim me ligj:

1. Në aktvendimin për hedhjen e kallëzimit penal si më sipër, Prokurori Munishi ka autorizuar Policinë e Kosovës për sekuestrimin e dosjeve origjinale që kanë të bëjnë me dosjet e provimit të jurisprudencës në Arkivin e Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë.
2. Në këtë aktvendim askund nuk përmendet nëse dosjet e sekuestruara janë marrë në pajtim me nenin 112 të KPP të Kosovës.
3. Ky nen përcakton se sendet që përkohësisht mund të sekuestrohen janë sende që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, sende ose pasuri që kanë mundësuar kryerjen

e veprës penale, ose sende që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh sekuestrimin.⁶

4. Dosjet e sekuestruara janë marrë pa vendim të gjykatës.
5. Dosjet e sekuestruara janë mbajtur më shume se pesë ditë, pa vendim të gjykatës.
6. Sipas KPP, sendet, pasuria, provat apo paratë mund t'i nënshtrohen kufizimit të përkohshëm sipas urdhrorit të shtetit që zgjat jo më shumë se pesë ditë nëse zyrtarët e autorizuar të policisë mësojnë për sendin, pasurinë, provat apo paratë e tilla gjatë kontrollit apo arrestit të ligjshëm.
7. Sipas KPP, prokurori i shtetit kërkon urdhër të gjykatës nga gjyqtari i procedurës paraprake.⁷ Kjo nuk figuron në aktvendim se ka ndodhur, pra nuk ka pasur asnjëherë vendim të gjykatës.
8. Prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lëshojë urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, pasurisë, provave apo parave.
9. Kërkesa e tillë duhet të cekë me saktësi sendet, pasurinë, provat apo paratë dhe duhet të përshkruajë si mund të jenë këto sende prova të veprës penale, si këto sende, pasuri apo para mund të mundësojnë kryerjen e veprës penale, ose si këto sende, pasuri apo para përbëjnë dobi pasurore të fituar me vepër penale.
10. Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur KPP ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.
11. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme.

V. Anshmëria e prokurorit në sigurimin e provave dhe dëshmive

Prokurori Kujtim Munishi në hetimin parapenal të kundërligjshëm të zhvilluar për një vepër penale të parashkruar, ka vendosur për 21 ditë të hedh kallëzimin penal, pa arritur të sigurojë një numër të provave dhe dëshmive, të cilat janë përcaktuese për zbardhjen e të vërtetës për dosjen e manipuluar të shefit të tij, Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi. Prokurori Munishi ka mbledhur prova dhe dëshmi jorelevante, të cilat nuk dëshmojnë asgjë në drejtim të vërtetimit të gjendjes faktike mbi dyshimet e falsifikimit të dosjes së Lumezit.

⁶*Shënim:* Interpretim i kësaj dispozitë sipas Komentarit të KPP të Kosovës është si vijon: sipas dispozitës së paragrafit 1, mund të sekuestrohen përkohësisht tri lloje sendesh: a) sendet që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, b) sendet ose pasuria që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, ose c) sendet që konsiderohen si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale. Sendet të cilat mund të jenë provë në procedurë penale, janë prova materiale që kanë regjim të posaçëm, nëse njëkohësisht nuk janë sende të cilat duhet të merren sipas Kodit penal. Sendet e tilla nuk është e thënë se duhet të shërbejnë drejtpërdrejt për qëllim argumentimi. Mund të merren, p.sh., shkresat për t'i mundësuar ekspertit krahasimin e dorëshkrimit ose të nënshkrimit dhe dhënien e mendimit për autenticitetin e tekstit të inkriminuar.

⁷Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve, pasurisë, provave apo parave bëhet me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake. Mirëpo, për gjësendet që janë objekt i kufizimit të përkohshëm, për të cilat zyrtarët e autorizuar të policisë mësojnë me rastin e kontrollit ose arrestit të ligjshëm, kufizim të përkohshëm mund të bëjë prokurori i shtetit për një kohë jo më shumë se pesë ditë. Krahas kësaj, Prokurori i shtetit kërkon urdhër për sekuestrim të përkohshëm të tyre nga gjyqtari i procedurës paraprake. Kërkesa e prokurorit duhet të përmbajë me saktësi sendet, pasurinë, provat apo paratë, të cilat mendon se duhet të sekuestrohen përkohësisht, dhe duhet të përshkruajë si gjësendet e tilla mund të jenë prova të veprës penale, si mundësojnë ato kryerjen e veprës penale, ose si përbëjnë dobi pasurore të fituar me vepër penale.

Meqenëse në hetimin parapenal, prokurori Munishi, apriori ka amnistuar dyshimet e ngritura se Aleksandër Lumezi e ka falsifikuar provimin e jurisprudencës, hetimi i tij është fokusuar në mbledhjen e provave dhe dëshmime që në çfarëdo forme shkojnë në favor të vërtetimit të tezës së nuk ka falsifikim të provimit të jurisprudencës. Tërë hetimin e ka bazuar përmes marrjes së dëshmime të dëshmitarëve në mënyrë të kundërligjshme, tërë hetimi i tij nuk ka pasur asnjë të dyshuar, dhe ka sekuestruar dosje pa urdhër të gjykatës.

Mbyllja e rastit është bazuar në tërësi në dëshmitë e ish-zyrtarëve serbë të caktuar në pozita në kohën e masave të dhunshme në vitet e 90-ta, pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës, me përjashtim të dëshmisë së avokatit Betim Shala, e cila nuk vërteton asgjë sepse është një supozim, i cili në procedurë penale nuk konsiderohet provë.

Prokurori Munishi nuk ka bërë administrimin e provave të ofruara nga dëshmitari Adil Fetahu. Ai ka qenë anëtar i Komisionit, i cili e ka intervistuar Aleksandër Lumezin në vitin 2000 kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror. Në procesverbal shkruan se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës. Një tjetër procesverbal i këtij Komisioni, nxjerr në pah se në vitin 2000, ish-Shefi i UNMIK-ut Bernard Kushner, kishte dekretuar 31 kandidatë jashtë propozimeve të komisionit në kundërshtim me ligjin, ku ishin dekretuar edhe kandidatë pa provim të jurisprudencës. Asnjëra prej këtyre provave që janë procesverbale të vitit 2000 nuk janë administruar nga prokuroria. Për më tepër, sic u theksua më lartë, mbetet e paqartë se si prokurori Munishi është ngutur për mbyllur rastin pa sigurimin e dosjeve të UNMIK-ut dhe OSBE-së, të cilat do të qartësonin, nëse Aleksandër Lumezi ka pasur apo jo provim të jurisprudencës në vitin 2000 dhe nëse Lumezi është njëri nga 31 kandidatët e dekretuar në mënyrë të kundërligjshme dhe pa provim të jurisprudencës apo nëse e ka pasur të vërtetohet në tërësi.

Hulumtimi ka dëshmuar se gjithçka që ndërlidhet me provimin e jurisprudencës së Aleksandër Lumezit është e manipuluar në kuptim të ndërhyrjeve me llak dhe mbishkrim të emrave tjerë. Këtu përfshihen: libri i paraqitjes së provimit jurisprudencës, mbështjellësi i dosjes bazë mbi dhënien e provimit, procesverbali i provimit. Edhe pse janë ngritur dyshime se këto dokumente mund të jenë manipuluar në kohë të ndryshme, prokurori Munishi asnjë prej këtyre dokumenteve nuk i ka dërguar për ekspertizë grafologjike për të dëshmuar kohën se si dhe kur janë bërë këto ndërhyrje, para apo pas luftës.

Prokurori Munishi ka bërë administrimin e provave – librave dhe regjistrave të manipuluar me llak, duke u bazuar në dëshminë e Radislav Dimitrijeviq, për të cilat ka ardhur në përfundim se në tërësi kanë qenë gabime të administratës dhe asgjë më shumë. Por, vetëm një ekspertizë grafologjike do të zbulonte nëse këto gabime janë bërë në vitin 1991 apo në vitin 2000.

Anshmëria e Prokurorit Munishi, në vijim të këtij raporti, është shtjelluar përmes analizës paralele që IKD i ka bërë secilit prej dëshmime dhe dokumenteve të trajtuara nga Prokurori Munishi, si dhe të atyre që është dashur të trajtohen e që nuk janë trajtuar. Kjo analzië paralele e IKD ka të bëjë me sa vijon:

- *Provat e kundërligjshme, sic shihet nga krahasimi i interpretimit të Prokurorit Munishi dhe me atë të IKD-së*
- *Injorimin e tërësishëm të provave nga Prokurori Munishi si dhe i dëshmisë së dëshmitarëve të vitit 1999/2000; dhe, së fundi,*
- *Ekspertizën e dokumenteve jashtë vendit, veprim që nuk është ndërmarrë nga ana e Prokurorit Munishi*

a). Provat e kundërligjshme, interpretimi i prokurorisë dhe IKD-së

Hetuesit e Policisë nën autorizimin e prokurorit Kujtim Munishi, kanë sekuestruar në mënyrë të kundërligjshme dosjet në Arkivin e Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë. Sipas aktvendimit të sipërcekur për hedhjen e kallëzimit penal, policia ka sekuestruar këto dokumente, të cilat më poshtë jepen ashtu sic janë cituar në aktvendimin për mbylljen e hetmieve nga Prokurori Munishi, duke cituar faqet e tij, përkatësisht për sa vijon:

- Lëndën e procesverbalit të dhënies së provimit të judikaturës, me numër 02/152-1-217/90, të kandidatit Aleksandër Lumezi, që përmbante: Mbështjellësin dhe dy fletë me katër faqe. Ky procesverbal, sipas Prokurorit Munishi dëshmon se kandidati Aleksandër Lumezi, i ka plotësuar të gjitha kushtet për t'iu nënshtruar provimit. Kjo, sipas Prokurorit Munishi dëshmohet me procesverbalin si më sipër të provimit të judikaturës, faqja e parë, ku thuhet: "Nënshtrimi në provim është lejuar me aktvendimin e këtij sekretariati nr.152-1-217datës11.02.1991".
- IKD: Prokurori Munishi, megjithatë, nuk sqaron se ku është ai aktvendim, si dhe aktvendimi i Sekretariatit Republikan që përmendet dy rreshta më sipër në faqen e njëjtë. Në ndërkohë që aktvendimet e Sekretariatit Krahinor gjenden në Arkivin e Kosovës, ato të Sekretariatit Republikan gjenden në Arkivin e Serbisë në Beograd.

Ndryshe, faqja e parë e mbështjellësit të dosjes bazë të Aleksandër Lumezit është e manipuluar me ndërhyrje të llakut të bardhë. Në këtë faqe të vulosur në sipërme të majtë, shkruan data e paraqitjes së provimit 17.10.1990, njësia organizative me numër 02/152-1-217/90. Në anën e djathtë shkruan shenja e klasifikimit 152. Lënda shkruanme shkronja latine Aleksandar Ljumezi. Tek kjo pjesë e lëndës dosja është e manipuluar me ndërhyrje të llakut të bardhë, mbi të cilën është shkruar Aleksandar Ljumezi. Nën llakun e bardhë nën vëzhgimin e dritës, vërehet i shkruar në cirilikë emri Zymer Krasniqi. Më poshtë evidentohet afati i ruajtjes që shkruhet në cirilikë përgjithmonë. Evidentohet numri nga libri intern 1146. Krejt në fund në anën e majtë shkruan në cirilikë vendi – Prishtinë dhe data e mbylljes së dosjes 09.05.1991. Dhe në anën e djathtë në fund është nënshkrimi i përgjegjësit që e ka përpunuar lëndën. Prokuroria nuk e ka siguruar aktvendimin për ta prezantuar para publikut, i cili ia lejon Aleksandër Lumezit nënshtrimin në provim. Prokurori Munishi vetëm e citon një të dhënë, e cila gjendet në procesverbal, por nuk ofron vendim.

- Një libër në të cilin në kopertinë ishte i vendosur nga Arkivi i Kosovës një fletë e bardhë me mbishkrimin: "Libri mbi lejimin e hyrjes në provimin e judikaturës viti 1990-1992", mirëpo në kopertinë kishte edhe shkrime tjera me laps-kimik në gjuhën serbe ("Popis akata" dhe "Prijave za pravosudni ispit").

- IKD: Nga sa mund të vërehet shënimet në këtë libër janë në origjinal. Në këtë libër në numrin rendor 217 shkruan në cirilikë Aleksandar Lumezi, ndërsa në rubrikën lëvizja e lëndëve, evidentohet 02 dhe shkruan data e paraqitjes së provimit të jurisprudencës 17/10. Edhe në këtë libër, sikurse nëmbështjellësin e dosjes bazë të provimit, faqja është manipuluar me llakun e bardhë, i cili ka mbuluar sërish Zymer Krasniqin, ndërsa mbi te është shkruar Aleksandar Lumezi. Poshtë emrit kishte qenë e shkruar në cirilikë Deçane, por ajo është mbuluar me llak të bardhë dhe mbi te nuk është shkruar asgjë tjetër. Për dallim nga faqja e parë e mbështjellësit të dosjes, ku shkruante në gjuhën serbe me alfabet latin Aleksandar Ljumezi, në librin e regjistrimit të paraqitjes së provimeve mbi llakun e bardhë shkruan në cirilikë dhe mbiemri dallon, në vend të Ljumezi është shkruar Lumezi. Në këtë faqe, vërehen ndërhyrje me llak të bardhë edhe tek dy kandidatë të tjerë me numrin rendor 213 dhe 220.
- Mbështjellësin e kandidatëve që kanë dhënë provimin e judikaturës, i vitit 1991, prej 60 personave.
- **MBËSHTJELLËSIN E DOSJEVE PËR KANDIDATËT QË KANË DHËNË PROVIMIN E JUDIKATURËS.** Në këtë mbështjellës shihet një mbishkrim "Sekretariati i Judikaturës dhe Administratës të Kosovës 1991, kanë dhënë provimin e judikaturës". Nga kjo listë , e cila ka 60 kandidatë, nën numrin rendor 2 është Aleksandër Lumezi (faqe 14).
- IKD: Prokurori Munishi e ka prezantuar si provë një mbështjellës të dosjes së disa kandidatëve, të cilët e kanë dhënë provimin e jurisprudencës në vitin 1991, të siguruar në Arkivin e Kosovës. Në këtë mbështjellës, i pari shkruan se është Agim Kurmehaj, i pasuar nga Aleksandër Lumezi dhe kandidatët e tjerë deri në numrin rendor 60-të. Ky mbështjellës nëse është përgatitur në vitin 1991, si ka mundësi që është shkruar në gjuhën shqipe, kur çdo dosje dhe shkrim tjetër i evidentuar është shkruar në gjuhën serbe dhe atë në cirilikë, përfshirë edhe librin amzë ku janë regjistruar kandidatët që e kanë dhënë provimin. Në këtë mbështjellës në pjesën e poshtme të anës së djathtë, shkruan $60+80=140$. Nëse në këtë mbështjellës të dosjeve kanë qenë 60 dosje të kandidatëve, siç edhe shkruhet se janë evidentuar, atëherë në një vend tjetër do duhej të ishin edhe 80 dosje të kandidatëve të tjerë të evidentuara me mbështjellës. Hulumtimi dëshmon se në librin amzë, i cili gjendet në Ministrinë e Drejtësisë, ku figurojnë kandidatët që e kanë dhënë provimin e jurisprudencës në vitin 1991, rezulton se në këtë vit (1991) e kanë dhënë provimin e jurisprudencës 124 kandidatë dhe jo 140 siç del nga kjo e dhënë e cila figuron në mbështjellës. Në raport me provat tjera që bazohen në librat e regjistrimit, dosjen bazë dhe certifikatën, kjo provë e prezantuar nga prokuroria nuk ka relevancë. Gjithashtu, kjo dhe provat tjera për t'u vlerësuar në një procedurë penale duhet të dërgohet në ekspertizë grafologjike për t'u vërtetuar koha kur është shkruar mbi te.
- Libërin me mbishkrim "Provimi profesional me PSP dhe PLP i viteve 1989-90-1991" me numër nr.15.
- **LIBRIN E PARAQITJES SË PROVIMIT PROFESIONAL ME PSP DHE PLP, I VITEVE 1989-90-1991,** me te cilin vërtetohet se zyrtari i shkrimores gabimisht e ka evidentuar në këtë libër Aleksandër Lumezin, me numër rendor 1 datë 09.01.1991. (faqe 14)

- IKD: Hulumtimi dëshmon se ekzistojnë tri libra të paraqitjes së provimeve (provimi i jurisprudencës, provimi për gjykatës për kundërvajtje dhe provimi profesional). Hulumtimi dëshmon se Aleksandër Lumezi ka figuruar vetëm në librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës dhe atë mbi emrin e Zymer Krasniqit. Ndërkohë, pas mbylljes së hetimit, Prokuroria ka publikuar edhe dy libra të tjerë. Aleksandër Lumezi figuron se i ka paraqitur dy provime: të jurisprudencës dhe provimin profesional. Atëherë, gjendja duket kështu:
 - Për herë të parë Lumezi e ka paraqitur provimin e jurisprudencës, por vetëm mbi dosjen e Zymer Krasniqit ku evidentohet data 17 tetor 1990.
 - Për herë të dytë Lumezi e ka paraqitur provimin profesional, ku evidentohet data 9 janar 1991.
 - Zymer Krasniqit figuron se e ka paraqitur provimin e jurisprudencës me datën 17 tetor 1990, por që është fshirë dosja e tij me llak dhe është shkruar Aleksandër Lumezi.
 - Në librin e paraqitjes provimit për gjykatës për kundërvajtje figuron kandidati Zimer Krasniqi nga Prishtina, i cili e ka paraqitur provimin më 11 janar 1991.
 - Nuk dihet nëse bëhet fjalë për të njëjtin person, siç ka konstatuar prokurori Munishi, sepse janë dy emra dhe dy vendlindje të ndryshme: Zymer Krasniqi është nga Deçani, ndërsa Zimer Krasniqi është nga Prishtina.

Janë disa pyetje në të cilat publiku don përgjigje prej Prokurorisë së Shtetit dhe atë si vijin:

Pse Aleksandër Lumezi e ka paraqitur edhe provimin profesional, përveç provimit të jurisprudencës?

Çfarë logjike ka që pas paraqitjes së provimit të jurisprudencës të paraqitet edhe provimi profesional, i cili për nga rëndësia dhe vlera është më i ulët sesa jurisprudenca? Pse në dëshminë e tij, Lumezi nuk ka deklaruar asnjëherë që ka paraqitur dy provime: provimin e jurisprudencës dhe provimin profesional?

Pse Aleksandër Lumezi u shkrua mbi dosjen e Zymer Krasniqit dhe vetëm në bazë të të dhënave të kësaj dosjeje përputhet gjithçka me certifikatën e provimit të prezantuar nga Lumezi?

- Librin në kopje me mbishkrim “Librat e provimeve të dhëna të Judikaturës i viteve 1986-1993” me nr.11.
- Librat librat e dhënies së provimit të judikaturës për periudhat 1986-1992, të marra nga Ministria e Drejtësisë më datë 26 tetor 2017 rreth orës 09:20 . (faqe2)
- LIBRIN E DHËNIES SË PROVIMIT TË JUDIKATURËS. Në këtë libër shihet qartë se kandidati Aleksandër Lumezi e ka kryer provimin e Judikaturës, numri rendor 30, numri i lëndës 152-1-217/90, dt.06.05.1991, data e dhënies së provimit 25.04.1991. (faqe 14)
- ÇERTIFIKATËN E DHËNIES SË PROVIMIT TË JUDIKATURËS TË ALEKSANDËR LUMEZIT, datë 06.05.1991 (faqe 14)
- IKD: I vetmi libër origjinal, në të cilin përputhen të dhënate kandidatit Aleksandër Lumezi me certifikatën e dhënies së provimit, me dosjen bazë dhe librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës është libri amzë i provimeve të dhëna të judikaturës për vitet 1986-1992, i cili është sekuestruar nga Ministria e Drejtësisë. Ky libër deri në mesin e vitit 1991, kur edhe

ishte larguar nga puna nga masat e dhunshme, ishte mbajtur nga Sahit Shala , ish-Sekretar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Në publik janë ngritur dyshimet tek mbyllja e librave në mënyrë të kundërligjshme, pasi cdoherë këto libra janë mbyllur nga Sekretari dhe Kryetari i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Pas përfundimit të luftës në vitin 2000/2001 këto libra janë gjetur dhe janë mbajtur sërish nga ish-Sekretari Sahit Shala. Ky i fundit, vitet e hapura 1991 dhe 1992 i ka mbyllur vetë, dhe sipas deklaratës së tij, këtë e ka bërë për të pamundësuar keqpërdorimin e librit me plotësim të kandidatëve tjerë, të cilët nuk e kanë dhënë provimin e jurisprudencës. Të dhënat e Aleksandër Lumezit në librin amzë mbi dhënien e provimit të jurisprudencës përputhen vetëm me të dhënat e plotësuara mbi dosjen e Zymer Krasniqit dhe askund tjetër. Derisa deklaratat e Zymer Krasniqit përputhen në tërësi me gjetjet e hulumtimit mbi dosjen e tij personale dhe dosjet që ekzistojnë të ruajtura mirë në Arkivin e Kosovës.

Në anën tjetër, në të njëjtën kohë, as libri amzë e as certifikata e dhënies së provimit nuk përputhen me procesverbalin e provimit të Aleksandër Lumezit. Sipas procesverbalit të provimit të Aleksandër Lumezit, rezulton se ai e ka kryer provimin më 26 prill 1991 dhe jo me 25 prill 1991, siç shkruan në librin amzë dhe në certifikatë, të cilën e ka prezantuar vetë Lumezi në publik.

- Me datë 02.11.2017, në Arkivin e Kosovës është gjetur lista e të gjithë kandidatëve që iu janë nënshtruar provimit dhe riprovimit me date 23/24 prill 1991, ku në mesin e kandidatëve figuron edhe emri i Aleksandër Lumezit. Me këtë rast është siguruar lista e anëtarëve të komisionit për dhënien e provimit e provimit të judikaturës dhe janë marrë një kopje nga dosjet e dy kandidatëve tjerë : Vasic Branislava dhe Ciric Cvetanka, me qëllim të krahasimit me dosjen e Aleksandër Lumezit.
- PROCESVERBALIN E DATËS 23 dhe 24. 04. 1991. Në këtë procesverbal, nën numrin rendor 12, mund të shihet qartë se Aleksandër Lumezi, është njeri nga kandidatët që kambetur në riprovim. (faqe 13)
- IKD: Në provat e Prokurorisë së Shtetit të prezantuara për publikun në faqen 11, vërehet se prokurori Munishi ka bërë një seleksionim të prezantimit të tyre, për arsye të cilat publiku nuk i di. Përmes kësaj prove, ai vendos ta vlerësojë atë si gjetje, e cila dëshmon se Aleksandër Lumezi e ka dhënë provimin e jurisprudencës.

Prokurori Munishi ka prezantuar për publikun listën e kandidatëve që kanë hyrë në provim dhe riprovim, e cila thuhet se është gjetur në origjinal në Arkivin e Kosovës. Faqja e parë është skanuar vetëm në pjesën e epërme ku shihet data. Kjo liste i takon datës 23 dhe 24 prill 1991, por e cila nuk mban asnjë vulë apo nënshkrim të ndonjë zyrtari përgjegjës. Në këtë pjesë të vogël të faqes, figuron vetëm një person me emrin Esad Shaboviq. Tutje, tërë kjo faqe nuk vërehet më, pasi është mbuluar me faqen e dytë. Në faqen e dytë është një listë tjetër e kandidatëve që kanë mbetur në riprovim. Kjo listë nuk mban asnjë datë, as vulë dhe as nënshkrim të ndonjë zyrtari përgjegjës. Në këtë liste më numër rendor 12 figuron Aleksandër Lumezi, i cili shkruan se ka mbetur në ri-provim në të drejtën civile dhe të drejtën ekonomike.

KPP i Kosovës në mënyrë taksative përcakton se dokumentet e sekuestruara duhet të fotografohen dhe regjistrohen. Prokurori Munishi nuk ka ofruar dëshmi se kjo listë e publikuar është fotografuar dhe e regjistruar në bazë të KPP të Kosovës dhe të japë sqarime, pse faqja e parë e kësaj liste ka vetëm pjesën e epërme dhe është e mbuluar me faqen e dytë? Përveç kësaj, Prokurori Munishi duhet të sqaroj publikun pse faqja e dytë nuk mban asnjë datë, as vulë dhe as nënshkrim të ndonjë zyrtari përgjegjës?

- Me datën 2 nëntor 2017, në Gjykatën e Apelit, hulumtimi ka siguruar dosjen e Aleksandër Lumezit, me dokumentet për sa vijon.
 - Kopje një faqe e librit amzë.
 - Dosja e praktikantit Aleksandër Lumezi, e cila përmban: aktvendime të pushimeve të lejuara, për lidhjen e marrëdhënies së punës, për pagesë, kërkesë për pagesë të pushimit para hyrjes në provim të judikaturës, aprovim i pushimit, vërtetim mbi çregjistrimin e sigurimit, aktvendim mbi të ardhurat personale, lutje për punësim, aktvendim për kryerjen e praktikës dhe aktvendim për praninë në punë si praktikant.

IKD: Për dallim prej Zymer Krasniqit, i cili pasi e kishte marrë certifikatën më 12 tetor 1990, pas 5 ditëve, më 17 tetor 1990 e kishte paraqitur provimin dhe kjo figuron në librin origjinal të regjistrimit të kandidatëve, mbi të cilin është ndërhyrë me llak dhe është shkruar Aleksandër Lumezi, ndërkohë që ky i fundit në dosjen personale nuk ka vërtetim të Gjykatës së Qarkut që e ka përfunduar praktikën një vjeçare, e cila ka qenë kusht ligjor për ta paraqitur provimin. Sipas dosjes personale të praktikantit Aleksandër Lumezi, rezulton se ai ka lindur më 07.08.1964, në Prizren. Ai ka përfunduar Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës më 13.04.1989. Sipas të dhënave të dosjes rezulton se Lumezi ka qenë praktikant gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë prej 01.11.1989 deri më 31.10.1991 Por, për dallim prej Zymer Krasniqit, Aleksandër Lumezi bazuar në të dhënat e dosjes së tij, rezulton se nuk e ka përfunduar një vit të punës praktike. Sipas të dhënave të Lumezit, rezulton se ai e ka filluar punën praktike më 01.11.1989, ndërsa provimin e ka paraqitur më 17.10.1990, pra dy javë para së të mbushë një vit punë praktike. Askund nuk ka vërtetim të gjykatës për punën praktike njëvjeçare, e cila sikurse në rastin e Zymer Krasniqit, shërben për ta paraqitur provimin e jurisprudencës.

- Me datë 03.11.2017, Prokurori Munishi ka dorëzuar kërkesë në OSBE, ku kemi kërkuar dosjet për rekrutimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në periudhën 1999-2000, mirëpo nuk ka marrë asnjë përgjigje.

IKD: Praktika gjyqësore nuk njeh që një rast të mbyllet me shpejtësinë e dritës pa marrë përgjigje nga institucioni kryesor që mban disa prej dokumenteve më kryesore që ndihmojnë në zbardhjen e këtij rasti. KPP e njeh institutin e pezullimit të procedurës penale, në rastet kur me qëllim të zbardhjes së të vërtetës personi i dyshuar është jashtë shteti, dhe i njëjti nuk mund të gjendet. Nuk ka logjikë që rasti të mbyllet pa pranuar përgjigje përfundimtare për dokumentet kryesore nga UNMIK-u. Nuk është e qartë se pse Prokurori Munishi nuk ka pasur durim të pret përgjigje nga UNMIK-u dhe OSBE-ja, por e ka mbyllur rastin edhe pse këto dëshmi do të ndihmonin shumë në zbardhjen e rastit për këto arsye:

Gjatë hulumtimit “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavisioni kanë siguruar dokumente e procesverbale, sipas të cilave, Aleksandër Lumezi, nuk kishte pasur provim të jurisprudencës kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror, pas përfundimit të luftës në Kosovë. Procesverbalet që e dëshmojnë një gjë të tillë janë përpiluar në vitin 2000. Vërtetësinë e këtyre procesverbaleve e kanë katër dëshmitarët e gjallë që aso kohe ishin pjesë e Komisionit Konsultativ Juridik. Ish-Kryetari i këtij Komisioni, Riza Smaka dhe tre anëtarët Adil Fetahu, Ragip Halili dhe Bajram Krasniqi, duke dëshmuar se të dhënat e këtyre procesverbaleve janë të sakta.

Sipas dokumentit të evidentuar si vërejtje hyrëse, rezulton se në kohën kur kishte konkurruar Aleksandër Lumezi për gjykatës dhe prokurorë, kishin konkurruar 305 kandidatë për gjykatës, prokurorë dhe gjykatës për kundërvajtje. Ky Komision ua kishte marrë shënimet, të cilat i kishte evidentuar për secilin kandidat, duke përfshirë të dhënat personale, vitin e kryerjes së fakultetit juridik, vitin e dhënies së provimit të jurisprudencës dhe përvojën e punës. Prej 305 kandidatëve, 74 kandidate kishin qenë femra, 5 kandidatë të minoritetit serb dhe malazez, ndërsa mosha mesatare e tyre kishte qenë 42 vjet. Sipas procesverbalit, rezulton se 88 kandidatë që kishin konkurruar e kishin shkruar në aplikacion se e kanë dhënë provimin e jurisprudencës ose atë profesional apo që të dyja. Rrallë ndonjë kandidat ia ka bashkangjitur aplikacionit certifikatën e provimit të dhënë. Prandaj, në intervista ishin ftuar të gjithë kandidatë, të cilët nuk dihej se a e kishin dhënë provimin.

Tutje në procesverbal shkruan se shumë kandidatë të paraqitur në konkursin e dytë, nuk i kanë plotësuar kriteret formale të Rregullores, respektivisht të konkursit, ngase nuk kanë pasur përvojë juridike e as provimin e jurisprudencës. Ata janë kryesisht kandidatë, të cilët e kanë kryer fakultetin pas vitit 1985 e këndeje (74 kandidatë), të cilët nuk kanë pasur shanse të punësohen, të fitojnë eksperiencë juridike e as ta japin provimin e jurisprudencës.

Sipas këtij procesverbal të përgatitur për të gjithë kandidatët, rezulton se Aleksandër Lumezi, i cili poashtu e ka kryer Fakultetin Juridik në vitin 1989, ka deklaruar para këtij Komisioni se nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës.

Për këtë kanë dëshmuar anëtarët e Komisionit, të cilët janë intervistuar gjatë këtij hulumtimi.

Megjithatë, aso kohe, më 1 dhjetor të vitit 2000, ishin ngritur shqetësime se në listat e dërguara tek Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, Bernard Kushner, ishin futur edhe kandidatë, të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore, duke i propozuar për gjykatës dhe prokurorë, kandidatët të cilët nuk e kanë pasur të kryer provimin e jurisprudencës.

Riza Smaka Kryetar i Komisionit, kishte kritikuar Kushnerin se kishte bërë gabim që kishte miratuar emërimin e disa personave. Ai kishte vërejtur disa ndryshime që janë bërë në listën, të cilën komisionin e ka propozuar. Smaka për këtë shqetësim e kishte informuar Bernard Kushnerin nëpërmjet një letre të dërguar më 14 nëntor 2000. Aty ia kishte përkujtuar atij se Departamenti i Çështjeve Juridike, në vend se ta përkrah punën e Komisionit, ata prapa shpinës së Komisionit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe kundër

ligjit si dhe kundër rregulloreve abuzuan me draftin e propozuar rreth emërimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve që i është dorëzuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, me disa ndryshime të listës së propozuar, përkundër kriterëve të Rregullores, pa e pasur autorizimin të bëjnë një gjë të tillë. Kandidatët e fortë janë larguar prej liste dhe kandidatët invalid i janë shtuar listës. Për këto devijime në futjen e personave në mënyrë të kundërligjshme, Smaka kishte kritikuar Sylvie Pantz dhe Nekibe Kelmendin si pjesë e Departamentit Administrativ të Drejtësisë. Por, Sylvie Pantz kishte reaguar, duke mos i pranuar ankesat e Komisionit. Ajo kishte mbështetur punën e Nekibe Kelmendit dhe kishte kërkuar të informohej nëse gjykatësit e emëruar në vitin 1999 dhe 2000 janë duke e kryer punën mirë apo jo.

Kritika për Nekibe Kelmendin, kishte pasur edhe anëtari tjetër i komisionit, Ragip Halili. Ai kishte thënë se Komisioni kishte refuzuar të rekomandojë një prej personave më me eksperiencë në gjyqësi për shkak të kriterit dhe parimeve që ata i kanë vendosur, por që Nekibe Kelmendi kishte emëruar njerëz të moshës 60 dhe 65 vjeçare, pa i thënë asgjë Komisionit dhe pa kurrfarë justifikimi.

Anëtarët e Komisionit kishin debatuar për një kohë në këto çështje, duke dhënë një numër të caktuar shembujsh.

Tutje, Ragip Halili kishte përkujtuar emërimet që ishin bërë nga Kushneri. Në disa rajone, sipas tij, emërimet ishin bazuar në propozimet e Komisionit, por disa kishin qenë jashtë listës së propozuar. Në këto raste, sipas tij, nuk është i mundur emërimi. Ai ka thënë se janë disa kushte si mosha, etika, provimi i judikaturës, të cilat duhet të respektohen, por që fatkeqësisht nuk janë respektuar çdo herë. Halili ka thënë se kishte deklaruar atë kohë dhe e thotë sërish se pjesë e sistemit prokurorial dhe gjyqësor ishin bërë edhe persona që nuk e kishin fare provimin e jurisprudencës.

Pakënaqësi kishte shprehur edhe Shaban Kajtazi, i kishte kërkuar Përfaqësuesit Special që nëse nuk pajtohej me rekomandime e Komisionit t'i kthente ato në rishqyrtim.

Edhe anëtari tjetër Tadej Rodiqi kishte shprehur pakënaqësi për disa gjykatës që nuk ishin zgjedhur përkundër nivelit të lartë që kishin pasur, por për këtë e kishte kritikuar Nekibe Kelmendin, pasi sipas tij, ata nuk ishin emëruar sepse nuk i kishin takuar partisë së Nekibe Kelmendit. Anëtari Rodiqi kishte kundërshtuar emërimin e disa personave, sepse sipas tij, ata kishin pasur lidhje me politikën dhe kishin qenë në kundërshtim me parimet për zgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve.

Bazuar në këtë procesverbal, 70 raste apo më shumë se 50 për qind e 139 kandidatëve të propozuar për pozitën e gjyqtarit dhe prokurorit nuk ishin emëruar ashtu siç ishin rekomanduar nga Komisioni.

- 27 kandidatë ishin larguar prej listës së propozuar prej Komisionit.
- 31 kandidatë ishin në listën finale pa u propozuar nga Komisioni.

- 12 kandidatë ishin transferuar prej pozitës së gjyqtarit në atë të prokurorit ose prej një gjykate në një gjykatë tjetër, pa u konsultuar fare me komisionin.

Derisa, sipas Kryetarit të Komisionit, Riza Smaka, Aleksandër Lumezi, nuk ishte dekretuar aso kohe në konkursin e shpallur, për shkak se vetë Lumezi kishte deklaruar se nuk e kishte dhënë provimin e jurisprudencës, në disa media është publikuar dekreti i Bernard Kushnerit për Aleksandër Lumezin në pozitën e zëvendësprokurorit në gusht të vitit 2000.

Të gjitha dokumentet dhe dosjet personale të 31 kandidatëve, të cilët sipas këtij procesverballi të vitit 2000 janë pranuar në kundërshtim me ligjin dhe pa provim të jurisprudencës mund të gjenden në UNMIK, OSBE ose në KPK. Prokurori Munishi nuk ka pasur durim të presë përgjigjen e këtyre institucioneve për ta zbardhur të vërtetën përtej çdo dyshimi të bazuar, por e ka mbyllur rastin.

Emisioni “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavision ende janë në pritje të përgjigjeve nga UNMIK-u.

- Me datë 07.11.2017, i është bërë kërkesë përmes emaili-t Timothy J.Baland-it, që ka punuar në Njësinë e Vlerësimit Profesional për Gjyqtarë dhe Prokurorë, në vitin 2009, për t’u përgjigjur në disa pyetje specifike lidhur me vlerësimin e kandidatëve. Me datë 08.11.2017, Timothy J.Baland është përgjigjur përmes emailit dhe ka thënë: “Si përgjigje ndaj pyetjes tuaj me email të datës 7 nëntor 2107, dëshiroj t’ju informoj se çdo diplomë provimi është verifikuar nga departamenti përkatës brenda Ministrisë së Drejtësisë nga juristët në Njësinë e Vlerësimit Profesional të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial.

Në mënyrë të veçantë, stafi i Njësisë së Vlerësimit Profesional, personalisht ka kontrolluar librat dhe regjistrimet relevante, duke përfshirë regjistrin në pajtim dhe mirëmbajtur nga Ministria e Drejtësisë, e atyre që kishin kaluar provimin e jurisprudencës.

Kjo punë është bërë në pajtim me rregullat e brendshme të punës që kanë qeverisur punën e Njësisë së Vlerësimit Profesional. Për informacionin tuaj, unë kam përfshirë një ekstrakt nga ato Rregulla me këtë përgjigje në kërkesën tuaj. Kam përfshirë gjithashtu një ekstrakt nga Raporti Përfundimtar mbi punën e Komisionit në lidhje me detyrat e Njësisë së Vlerësimit Profesional. Duke pasur parasysh kujdesin me të cilin anëtarët e Njësisë së Vlerësimit Profesional kanë ndërmarrë dhe kryer përgjegjësitë e tyre, është shumë e vështirë për mua të besoj se dikush do të kishte qenë në gjendje të falsifikonte ekzistencën ose vlefshmërinë e diplomës së provimit të jurisprudencës që ishte paraqitur nga një kandidat në lidhje me aplikimin e tij ose të saj. Megjithëse nuk jam i sigurt për këtë, është e mundur që njësia e verifikimit brenda Këshillit Gjyqësor të Kosovës të ketë disa arkiva nga puna e bërë nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial”.

- IKD: Për dosjen e manipuluar të Lumezit, ekipi i Kohavisionit dhe “Betimi për Drejtësi” kanë pyetur edhe Timothy Baland, Kryetar i Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, i cili kishte zhvilluar procesin e riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë në vitin 2009. Në një përgjigje përmes postës elektronike, Baland ka thënë se secila diplomë e provimit të jurisprudencës ishte verifikuar në departamentet relevante në Ministrinë e

Drejtësisë nga Njësi për Vlerësimin Profesional të këtij komisioni. Ai ka theksuar se bazuar në punën e këtij njësi, e ka të vështirë të besojë se dikush ka pasur mundësi të falsifikojë ekzistimin ose validitetin e diplomës së provimit të jurisprudencës, që ishte dorëzuar nga kandidatët në lidhje me aplikimin në pozitën e tij apo saj. Dëshmia e kryetarit Baland dëshmon se verifikimi i certifikatave të kandidatëve është bazuar vetëm në librat amzë të Ministrisë së Drejtësisë. Në këto të fundit, Aleksandër Lumezi figuron se e ka dhënë provimin më 25 prill 1991 në kohën e masave të dhunshme. Por dyshimet e ngritura në bazë të gjetjeve të hulumtimit bazohen në librin amzë të vitit 1991, i cili ishte mbyllur në mënyrë të kundërligjshme tek në vitin 2000. Mbylljen e librave e ka bërë Sahit Shala pa Kryetarin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Dëshmitari Shala ka thënë se e ka mbyllur librin pa prezencën e Kryetarit në mënyrë që të parandalojë mundësinë e keqpërdorimit të librit, për të shtuar emra të kandidatëve, të cilët nuk e kanë dhënë provimin. Të dhënat e Lumezit në këtë libër përputhen vetëm me të dhënat e plotësuara mbi dosjen e Zymer Krasniqit dhe askund tjetër. Derisa deklaratat e Zymer Krasniqit përputhen në tërësi me gjetjet e hulumtimit mbi dosjen e tij personale dhe dosjet në Arkivin e Kosovës. Ndërkohë, procesverbalet edhe anëtarët e Komisionit në krye me Riza Smakën kanë deklaruar se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës në vitin 2000 kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror. Këto dosje nuk dihet nëse janë ende tek UNMIK-u, OSBE-ja ose janë transferuar në KPK. Prokurori Munishi në aktvendim shkruan se ka kërkuar qasje në dosjet e UNMIK-ut dhe OSBE-së, por nuk i ka pritur përgjigjet dhe ka mbyllur hetimin parapenal.

- Është siguruar deklarata noteriale e anëtarit të Komisionit të Judikaturës Gjorgje Aksiq, në kohën kur Aleksandër Lumezi i është nënshtruar provimit të judikaturës. Deklarata thotë: “Me kërkesë të Aleksandër LUMEZI-it nga Prishtina me përgjegjësi të plotë jap këtë deklaratë: Certifikata mbi kalimin e provimit të Judikaturës me nr.02.br.152-1-1217/90 nga viti 06.05.1991 e cila më është dhënë në shikim, në të cilën thuhet se Aleksandër LUMEZI nga Prishtina me datën 25.04.1991 e ka dhënë provimin e Judikaturës unë e kam nënshkruar. Në bazë të raportit të komisionit për dhënien e provimit të Judikaturës, Sekretari Krahinor për Judikaturë ka qenë i autorizuar për ta nënshkruar Certifikatën për dhënien e provimit të Judikaturës”.
- IKD: Më 1 nëntor 2017, pas publikimit të akuzave se Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi, dyshohet se e ka falsifikuar provimin e jurisprudencës, Lumezi e ka siguruar një vërtetim nga ish-Sekretari Krahinor i Administratës dhe Judikaturës Gjorgje Aksiq, i cili rezulton se është vërtetuar nga noteri në Beograd të Serbisë, përmes të cilit Aksiq dëshmon se nënshkrimi i tij në certifikatën e Lumezit është nënshkrimi i tij. Gjatë raportimit të hulumtimit rreth dosjes së manipuluar të Lumezit, ekipi “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavisioni kanë dhënë argumente të dokumentuara dhe dëshmitarë të gjallë që flasin për dosjen e manipuluar dhe deklarin e vetë Lumezit se nuk e ka dhënë provimin kur ka konkurruar për gjykatës dhe prokuror menjëherë pas luftës. Asnjëherë nuk është kontestuar vërtetësia e nënshkrimit të Gjorgje Aksiqit. Ky vërtetim i Aksiqit shërben vetëm si dëshmi e autenticitetit të nënshkrimit që gjendet në certifikatën e Lumezit. Sipas vërtetimit të lëshuar me kërkesë të Aleksandër Ljumezit, Gjorgje Aksiq deklaroi me përgjegjësi të plotë se “Certifikatën për dhënien e provimit të judikaturës 02 nr.152-1-1217/90 të datës 06.05.1991, e cila më është dhënë në shikim, në të cilën shkruan se Aleksandër Lumezi nga Prishtina, më

dt. 25.04.1991 e ka dhënë provimin e judikaturës, e kam nënshkruar unë”. Por, hulumtimi dëshmon se certifikata është lëshuar një ditë para se Aleksandër Lumezi ta përfundon provimin e jurisprudencës, që sipas dosjes bazë, rezulton se nuk është kryer me 25, por më 26 prill 1991. Në këtë vërtetim shkruan se “Sipas raportit të Komisionit për dhënien e provimit të judikaturës, Sekretari Krahinor për judikaturë ka qenë i autorizuar për t’i nënshkruar certifikatat për provimet e judikaturës”. Ky vërtetim është noterizuar në Beograd të Serbisë. Nënshkrimi është bërë nga praktikantja e autorizuar nga noteri Dejan Radulloviq. Ai në përmbajtje të këtij dokumenti, deklaroi se nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e këtij dokumenti, por vetëm për formën, për të cilën Aksiq ka deklaruar se nënshkrimi i tij është origjinal në certifikatë. Gjatë hulumtimit në gazetën zyrtare në Bibliotekën e Kosovës, rezulton se Gjorgje Aksiq ishte emëruar në pozitën e Sekretarit Krahinor për Jurisprudencë e Administratë të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, gjatë kohës së masave të dhunshme, pas dëbimit të punëtorëve shqiptarë. Emërimi i Aksiqit ishte bërë më 19 korrik 1990 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës Socialiste të Serbisë Zoran Sokolovic. Para emërimit në këtë pozitë, Aksiq kishte qenë në pozitën e nënkryetarit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës.

Gjithashtu, këtu ritheksohet se Prokurori Munishi këtë provë e ka marrë në kundërshtim me ligjin. KPP dhe Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Kosovës në çështjet penale e konsideron të papranueshme një dokument gjyqësor apo jo gjyqësor që nuk është marrë përmes rrugëve diplomatike nga një shtet tjetër. Sido që të jetë, ky dokument ligjërisht është i papranueshëm. Është lëshuar nga një shtet tjetër, dhe nuk ka ardhur përmes rrugëve diplomatike, respektivisht përmes Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

- Me dt.13.11.2017, nga Arkivi i Kosovës kemi arritur të gjejmë librin e paraqitjes së provimit për gjyqtarët për kundërvajtje, me numër protokollit, 02/152-2 për vitin 1989/90. Në këtë libër nën numrin rendor 5, shihet kërkesa e kandidatit Zymer Krasniqi, që ka paraqitur kërkesën për dhënie të provimit për GJYQTAR PËR KUNDËRVAJTJE. (faqe 12)
- Poashtu është siguruar shkresa e lëshuar nga ish Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Deçan, e datës 12.10.1990 me numër protokollit 358/90, e nga ku shihet se Zymer Krasniqi ka punuar në këtë gjykatë si praktikant dhe se vërtetimin në fjalë e ka kërkuar me qëllim që t’i shërbejë për paraqitjen e provimit PËR GJYQTAR PËR KUNDËRVAJTJE. Nga ky fakt rezulton se edhe është bërë gabimi në evidentim, ngase kërkesa për dhënie të provimit për GJYQTAR PËR KUNDËRVAJTJE është evidentuar NË LIBRIN PËR DHËNIE TË PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS.

Duket se ky gabim është vërejtur me datë 11.01.1991 nga ana e referentit që ka bërë përmirësimin me korrektor, ashtu që z. Krasniqi e kanë regjistruar në mënyrë të drejtë në librin e paraqitjes së provimit për gjyqtarë për kundërvajtje me numrin rendor 5 e cila mban datën 11.01.1991 ndërsa në vend të tij në librin për dhënie të provimit të judikaturës kanë regjistruar atëkohë kandidatin Aleksandër Lumezi. (faqe 12).

- IKD: Zymer Krasniqi nga Deçani figuron se e ka paraqitur provimin e jurisprudencës me datën 17 tetor 1990, por që është fshirë dosja e tij me llak dhe është shkruar Aleksandër Lumezi. Në librin e paraqitjes provimit për gjykatës për kundërvajtje figuron kandidati Zimer Krasniqi nga Prishtina, i cili e ka paraqitur provimin më 11 janar 1991. Nuk dihet nëse bëhet fjalë për të njëjtin person, siç ka konstatuar Prokurori Munishi, sepse janë dy emra dhe dy vendlindje të ndryshme. Zymer Krasniqi është nga Deçani, ndërsa Zimer Krasniqi është nga Prishtina. Hulumtimi dëshmon gjithë deklaratën e Zymer Krasniqit se e ka përfunduar punën praktike njëvjeçare në ish-Gjykatën Komunale të Kundërvajtjes në Deçan dhe se më datën 12 tetor 1990 ka marrë vërtetimin e gjykatës për ta paraqitur provimin për gjykatës për kundërvajtje. Në dosjen e Zymer Krasniqit, mbi të cilën është shkruar mbi llak Aleksandër Lumezi, del se Zymer Krasniqi e ka paraqitur provimin 5 ditë pasi e kishte nxjerrë vërtetimin, përkatësisht me 17 tetor 1989. Kjo përputhet afërsisht edhe me kohën për të cilën Krasniqi ka deklaruar në polici, ku thotë se “dhe aq sa më kujtohet ka qenë kah fundi i nëntorit të vitit 1990, kur kam ardhur në Prishtinë dhe kam shkruar për ta paraqitur provimin”.

Në librin tjetër të paraqitjes së provimeve për gjykatës për kundërvajtje, me numër të protokollit 02/152-2 për vitin 1989/90, të sekuestruar dhe prezantuar si provë nga Policia, në numrin rendor 5, shkruan se Zimer Krasniqi nga Prishtina më datën 11 janar 1991 e ka paraqitur provimin për gjykatës për kundërvajtje. Prokurori Munishi, ka konstatuar se ky emër i takon Zymer Krasniqit nga Deçani edhe pse aty shkruan Zimer Krasniqi nga Prishtina. Tutje, prokurori Munishi vendos se, fakti i nxjerrjes së vërtetimit për punën praktikë njëvjeçare më 12 tetor 1990, nga ish-Gjykata Komunale e Kundërvajtjes në Deçan nga Zymer Krasniqi, përputhet me faktin e paraqitjes së provimit për gjykatës për kundërvajtje nga Zimer Krasniqi nga Prishtina me datën 11 janar 1991.

Prokurori Munishi ka vendosur se, “duket se ky gabim është vërejtur me datë 11.01.1991 nga ana e referentit që ka bërë përmirësimin me korrektor, ashtu që z. Krasniqi e kanë regjistruar në mënyrë të drejtë në librin e paraqitjes së provimit për gjyqtar për kundërvajtje me numrin rendor 5 e cila mban datën 11.01.1991 ndërsa në vend të tij në librin për dhënie të provimit të judikaturës kanë regjistruar atëkohë kandidatin Aleksandër Lumezi.”

Publiku ka interes të dij se si ka mundësi që kanë ndodhur gjithë këto gabime si në vazhdim:

1. Si ka mundësi që Zymer Krasniqi, i cili më 12 tetor 1990 e kishte nxjerrë vërtetimin për ta paraqitur provimin dhe që figuron se pas 5 dite e ka regjistruar, respektivisht më 17 tetor 1990 (siç edhe përputhet me deklaratën e tij dhënë në polici) të jetë regjistruar gabimisht dhe të jetë kuptuar pas pothuajse tre muajve, përkatësisht më 11 janar 1991?
2. Nëse është kuptuar se gabimisht është regjistruar Zymer Krasniqi nga Deçani në një libër tjetër, si ka mundësi që në librin tjetër shkruhet Zimer Krasniqi nga Prishtina? A është fjala për të njëjtin person? Si e ka vërtetuar këtë prokurori Munishi?
3. Nëse ka ndodhur ky gabim në regjistrim më 17 tetor 1990 dhe është kuptuar më 11 janar 1991 ku më pas është përmirësuar Zymer Krasniqi, atëherë si ka mundësi që Aleksandër Lumezi është shkruar sërish në dy libra të paraqitjes së provimeve? Pse Zymer Krasniqi është mbuluar me llak dhe mbi te në librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës është shkruar Aleksandër Lumezi dhe në të njëjtën kohë Aleksandër

Lumezi është regjistruar se e ka paraqitur edhe provimin profesional dhe atë me datë 9 janar 1991?

4. Nëse është gjetur njëherë gabimi se Zymer Krasniqi është regjistruar gabimisht në vend të Aleksandër Lumezit në librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës, pse atëherë është regjistruar edhe në librin e paraqitjes së provimit profesional me 9 janar 1991?
5. Pyetje logjike që mbështetet në ndërhyrjet që thuhet se janë bërë retroaktivisht në dosjen e Lumezit. Kur është kuptuar se emri Zymer Krasniqi është shkruar gabimisht në librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës dhe mbi të është përmirësuar retroaktivisht Aleksandër Lumezi, atëherë si ka mundësi që kandidati Zymer Krasniqi nuk është regjistruar me 17 tetor 1990 në librin e provimit për gjykatës për kundërvajtje (sikurse pretendohet se ka ndodhur me Lumezin) por është regjistruar me datën 11 janar 1991?
6. Si janë vërtetuar këto nga prokurori Munishi për të cilat ka vendosur këtë lidhje logjike, e cila sipas IKD-së nuk ka asnjë logjikë?

a) Prokurori Munishi injoron provat dhe dëshmitarët e vitit 1999/2000

Prokurori Kujtim Munishi nuk ka pasur durimin të presë përgjigje për të siguruar provat e Komisionit , i cili kishte bërë vlerësimin e kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë në vitin 1999 dhe 2000 pas përfundimit të luftës në Kosovë. Anëtarët e Komisionit, kanë ofruar procesverbale, sipas të cilave, aso kohe kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror, Aleksandër Lumezi nuk e kishte pasur provimin e jurisprudencës. Për vërtetësinë e këtyre procesverbaleve kanë dëshmuar edhe pesë prej anëtarëve të Komisionit Juridik Konsultativ, por të cilat nuk janë marr parasysh.

Prokurori Munishi në aktvendimin për hedhjen e kallëzimit penal ka potencuar se me datë 01.11.2017, i është bërë një kërkesë zyrës së UNMIK-ut, për ta siguruar dosjen e kandidatit Aleksandër LUMEZI, të cilit ia ka kryer verifikimin përmes Njësisë për Vlerësim Profesional. Sipas Prokurorit Munishi, nga të njëjtit Prokuroria e Shtetit nuk ka pranuar dosjen e kërkuar. E njëjta qasje është zbatuar edhe lidhur me kërkesën në OSBE.

IKD: Më poshtë janë radhitur provat relevante të cilat janë injoruar dhe provat për të cilat prokurori Munishi nuk ka pritur përgjigje për t'i siguruar, të cilat do të zbardhnin të vërtetën nëse Aleksandër Lumezi kishte pasur apo jo provim të jurisprudencës në konkursin e vitit 2000.

1. Prokurori Munishi e ka injoruar në tërësi procesverbalin e Komisionit , i cili dëshmon se kandidati Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës të deklaruar në vitin 2000 dhe për këtë arsye ishte përjashtuar nga emërimi si gjykatës.
2. Prokurori Munishi e ka injoruar në tërësi procesverbalin e Komisionit të vitit 2000, i cili dëshmon se atë kohë, jashtë propozimeve të këtij Komisioni, ishin propozuar emra për t'u emëruar si gjykatës dhe prokurorë, në kundërshtim me kriteret e konkursit, përkatësisht janë propozuar edhe kandidatë, të cilët nuk e kanë pasur të përfunduar provimin e jurisprudencës.
3. Prokurori Munishi e ka injoruar në tërësi procesverbalin e Komisionit , i cili dëshmon se ish-Shefi i UNMIK-ut, Bernard Kushner, kishte emëruar 31 gjykatës dhe prokurorë, të cilët nuk

ishin propozuar nga Komisioni , ku në mesin e tyre kishin qenë kandidatë që nuk e kanë pasur të kryer provimin e jurisprudencës.

4. Prokurori Munishi e ka injoruar në tërësi procesverbalin e Komisionit , i cili dëshmon se Kryetari Riza Smaka dhe anëtarët e këtij Komisioni, kishin kundërshtuar ashpër ndërhyrjet në listat e kandidatëve, duke theksuar se administratorit të UNMIK-ut , z. Bernard Kushner, iu janë dërguar emra të kandidatëve, të cilët nuk e kanë pasur provimin e jurisprudencës.

5. Prokurori Munishi e ka injoruar në tërësi mundësinë që UNMIK-u do të përgjigjet për të siguruar dokumentet e punës së UNMIK-ut, i cili kishte krijuar në vitin 1999/2000 Komisionin me shumicë vendore, të cilët së bashku me përfaqësues ndërkombëtarë kishin rekrutuar gjykatësit dhe prokurorët menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë.

6. Prokurori Munishi e ka injoruar në tërësi mundësinë që OSBE-ja do të përgjigjet për të siguruar dokumentet e punës së OSBE-së, i cila kishte ndihmuar në vitin 1999/2000 Komisionin me shumicë vendore, të cilët së bashku me përfaqësues ndërkombëtarë kishin rekrutuar gjykatësit dhe prokurorët menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë.

Praktika gjyqësore nuk njeh që një rast të mbyllet me shpejtësi marrë përgjigje nga institucioni kryesor që mban disa prej dokumenteve më kryesore që ndihmojnë në zbardhjen e këtij rasti. KPP e njeh institutin e pezullimit të procedurës penale, në rastet kur me qëllim të zbardhjes së të vërtetës personi i dyshuar është jashtë shteti, dhe i njëjti nuk mund të gjendet. Nuk ka logjikë që rasti të mbyllet pa pranuar përgjigje përfundimtare për dokumentet kryesore nga UNMIK-u. Nuk është e qartë se pse prokurori Munishi nuk ka pasur durim të pret përgjigje nga UNMIK-u dhe OSBE-ja, por e ka mbyllur rastin edhe pse këto dëshmi do të ndihmonin shumë në zbardhjen e rastit për këto arsye:

Gjatë hulumtimit “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavisioni kanë siguruar dokumente e procesverbale, sipas të cilave, Aleksandër Lumezi, nuk kishte pasur provim të jurisprudencës kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror, pas përfundimit të luftës në Kosovë. Procesverbalet që e dëshmojnë një gjë të tillë janë përpiluar në vitin 2000. Vërtetësinë e këtyre procesverbaleve e kanë katër dëshmitarët e gjallë që aso kohe ishin pjesë e Komisionit . Ish-Kryetari i këtij Komisioni, Riza Smaka, si dhe katër anëtarët: Adil Fetahu, Shaban Kajtazi, Ragip Halili dhe Bajram Krasniqi kanë dëshmuar se të dhënat e këtyre procesverbaleve janë në tërësi të sakta.

Prokurori Munishi ka marrë në pyetje Riza Smakën dhe Adil Fetahun, të cilët kanë dëshmuar në tërësi vërtetësinë e procesverbaleve, duke dëshmuar se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës në vitin 2000, gjë e cila është evidentuar në procesverbal. Këto procesverbale janë konfirmuar publikisht edhe nga tre dëshmitarët e tjerë Shaban Kajtazi, Ragip Halili dhe Bajram Krasniqi. Asnjëri prej tyre nuk është marrë në pyetje nga prokurori Munishi.

Madje, prokurori Munishi asnjëherë nuk i ka konsideruar procesverbalet dhe dëshmitë e pesë dëshmitarëve, të cilët konfirmojnë vërtetësinë e procesverbaleve, sipas të cilave Aleksandër Lumezi nuk e kishte provimin e jurisprudencës në vitin 2000. Kjo dëshmohet edhe me rastin e marrjes në pyetje të Aleksandër Lumezit, ku sipas aktvendimit për hudhjen e kallëzimit penal,

rezulton se prokurori Munishi nuk i ka parashtruar as pyetjet bazike, nëse Aleksandër Lumezi kur kishte aplikuar për prokuror dhe gjykatës pranë Komisionit në vitin 1999 dhe 2000, kishte deklaruar sipas procesverbalit dhe dëshmitarëve të gjallë, se nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës.

b) Ekspertiza e dokumenteve jashtë vendit

Dosja e dhënies së provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezit në tërësi është e manipuluar me llak e ndërtuar mbi dosjen e Zymer Krasniqit dhe në të gjitha dokumentet e të gjitha fazave për dhënien e provimit të jurisprudencës nuk përputhen. Të dhënat që përmbajnë ndërhyrje me llak të bardhë dhe të cilat nuk përputhen në mes vete përfshijnë: dosjen personale të praktikantit, librin e regjistrimit të paraqitjes së provimit, mbështjellësin e 60 dosjeve ku gjendet edhe dosja e Aleksandër Lumezit, mbështjellësin e dosjes bazë, procesverbalin mbi dhënien e provimit, librin amzë mbi dhënien e provimit të jurisprudencës dhe certifikatën e dhënies së provimit. Asnjëra nga këto nuk përputhet me dosjen bazë, që është në emër të Zymer Krasniqit nga Decani, të fashirë me llak të bardhë, mbi të cilin është shkruar emeri i Aleksandër Lumezit, sikundër që nuk përputhen ndërmjet veti.

Prokurori Kujtim Munishi përkundër faktit se të gjitha këto dokumente janë të manipuluar me llak dhe nuk përputhen në mes vete ka vendosur që mos të bëjë asnjë ekspertizë grafologjike të këtyre dokumenteve për t'iu përgjigjur shumë dilemave.

Në këto raste, kur ekzistojnë të gjitha këto dokumente të manipuluar me llak, ku dosjet ndërtohen mbi dosje, veprimi i parë që ndërmerr prokuroria është dërgimi i dokumenteve në ekspertizë grafologjike.

Ky është një rast që dëshmon anëshmëri të prokurorit dhe mungesë të vullnetit për ta zbardhur të vërtetën. Publiku ka të drejtë të bindet përmes provave dhe dëshmive se Prokuroria ka zhvilluar hetime të pavarura, të paanshme dhe profesionale me qëllim të zbardhjes të së vërtetës, gjë e cila në këtë rast nuk ka ndodhur.

VI. Interpretimi i dëshmive të dëshmitarëve sipas prokurorisë dhe IKD-së

Prokurori Kujtim Munishi sipas aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal formalisht ka zhvilluar hetim parapenal por praktikisht ka zhvilluar hetim penal, duke sekuestruar prova dhe duke marrë në pyetje dëshmitarë pa pasur aktvendim mbi fillimin e hetimeve. Në këtë proces hetimor parapenal Munishi nuk ka pasur asnjë person të dyshuar, por vetëm dëshmitarë. Në Kosovë në cilësinë e dëshmitarit janë marrë në pyetje: Sahit Shala, Radislav Dimitrijevic, Aleksandër Lumezi, Riza Smaka, Adil Fetahu, Enver Hasani, Betim Shala dhe Zymer Krasniqi.

Ndërsa, pa pasur vendim për fillim të hetimeve dhe kundërshtim me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar ka marrë prova dhe dëshmitarë jashtë rrugës zyrtare ligjore. Në këtë drejtim, ka marrë si provë një akt të noterizuar të Djordje Aksic i cili figuron si ish-anëtar i Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës në vitin 1991 dhe si ish-Sekretar Krahinor

në kohën e masave të dhunshme në Kosovë. Ndërsa, ka marrë në pyetje Miladin Kosticin gjithashtu ish-anëtar i Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës në vitin 1991.

Në mënyrë që deklarata e dërguar nga Djordje Aksic të konsiderohet si provë në Kosovë, në bazë të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar duhet të vijë përmes ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet penale. Kjo nuk ka ndodhur. Njëjtë vlen edhe për deklaratën e dëshmitarit tjetër, Miladin Kostic. Dëshmia e Kosticit dhe akti noterial i Aksic janë dokumente që në gjykatë janë të papranueshme.

Në vazhdim janë paraqitur dëshmitë e dëshmitarëve të interpretuara nga prokurori Kujtim Munishi dhe interpretimi paralel juridik sipas analizës së IKD-së. Interpretimet e Prokurorisë janë përshkruar pa ndërhyrje, sipas aktvendimit mbi hedhjen e kallëzimit penal.

1) Dëshimtari Sahit Shala (dëshmia e parë)

Me datë 26.10.2017, në orën 13:25, në cilësinë e dëshmitarit është intervistuar SAHIT SHALA, i cili prej vitit prill 1974 deri në vitin 1989, ka punuar në Sekretariatën Krahinor të Judikaturës.

Dëshmitarit i është prezantuar Libri me mbishkrim “Libri mbi lejimin e hyrjes në provimin e Judikaturës”, duke e pyetur se për çka ka shërbyer ky libër, dëshimtari ka treguar se libri në fjalë ka shërbyer si libër arkivues ku kandidatët kanë dorëzuar kërkesën për provim të judikaturës, duke shtuar se përpos këtij libri kanë qenë edhe dy libra tjera, libri mbi lejimin e provimeve dhe libri mbi dhënien e provimeve.

Dëshimtari ka treguar se llaku-korrektori është përdorur kur është bërë ndonjë gabim teknik, mirëpo në procesverbal të provimit të judikaturës nuk është përdorur. *(faqe 3 të aktvendimit)*

IKD: Sahit Shala është larguar së bashku me punëtorët e tjerë menjëherë pas përkrahjes së deklaratës së 2 korrikut 1990.

Hulumtimi dëshmon se në Arkivin e Kosovës ekzistojnë libra të regjistrimit të paraqitjes së provimit për:

- Provim të jurisprudencës
- Provim për gjykatës për kundërvajtje dhe
- Provimit profesional.

Në procesverbalin e provimit të Aleksandër Lumezit, llaku është përdorur edhe në procesverbal. Në faqen e fundit (4) të procesverbalit, është përdorur llaku për të fshirë aty ku është shkruar e drejta ekonomike dhe mbi të është shënuar e drejta civile.

Ka rëndësi të theksohet gjithashtu se Sahit Shala është ftuar si dëshmitar pa pasur aktvendim për fillimin e hetimeve. E njëjta vlenë edhe për dëshmitarët tjerë që kanë dhënë dëshmi e që citohen në aktvendimin për mbylljen e hetimeve.

2) Dëshmitari Sahit Shala (dëshmia e dytë)

Më datë 27.10.2017, ish-Sekretari Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, Sahit Shala, në një intervistë për ekipin e KTV-së dhe “Betimi për Drejtësi”, ka rrëfyer se si në vitin 89 kishte braktisur Komisionin e Jurisprudencës, duke lënë mbrapa të gjithë librat dhe gjithçka tjetër që lidhej me këtë provim në duart e masave të dhunshme.

Me date 30.10.2017 është intervistuar në cilësi të dëshmitarit prapë Sahit Shala, i cili në media është deklaruar: “asnjëherë nuk ka bërë përmirësime të tilla, siç shihen në dosjen e Lumezit”, sepse një gjë e tillë, sipas tij ka qenë ndaluar me ligj. (faqe 3 të Aktvendimit)

Dëshmitarin pasi e kemi ballafaquar me disa shkresa të cilat ai vet i kishte nënshkruar kishte pranuar se ka punuar edhe në vitin 1990. (faqe 4 e Aktvendimit)

Dëshmitari në polici deklaroi: “ka ndodhë që kam bërë përmirësime me korrektor me llak në librin e paraqitjes së provimeve, në protokol të Arkivit, në librin për lejimin e hyrje në provim dhe librin e dhënies së provimit, veprime këto që nuk kanë qenë të lejuara me ligj, por ka qenë praktikë”. Dëshmitarit i është prezantuar libri, ku i njëjti kishte bërë përmirësime në disa raste (Rasti të kandidatja Biljana Rexhiq dhe Afrim Shefkiu).

Në pyetjen, se pse në media ke thënë që nuk ke bërë përmirësime të tilla ndërsa neve na tregove që ke bërë përmirësime të tilla ndërsa neve na tregove që ke bërë përmirësime me llak-korrektor?! Dëshmitari është përgjigjur: “Kam rënë në lajthim nga pyetjet e gazetarëve”. (faqe 4 e Aktvendimit). **IKD:** Gjatë hulumtimit janë siguruar libra, në të cilat ka pasur ndërhyrje dhe në të cilat janë evidentuar ndërhyrjet më vërejtje anash. Në rastet e përmirësimit të ndonjë të dhëne është shënuar arsyetimi në vërejtje se pse kanë ndodhur gabimet njerëzore.

Sahit Shala është intervistuar dhe intervista e tij është transmetuar në dy medime. Në lajmet qendrore të KTV-së është transmetuar një prononcim i shkurtër, ndërsa në emisionin “Betimi për Drejtësi” (më 1 nëntor 2017) është transmetuar intervista e plotë.

Dëshmitari Sahit Shala decidivisht në intervistë ka thënë: “Unë nuk e mbaj mend që kam përmirësuar ndonjë datë apo diçka të provimit. Por edhe nëse ti e ke bërë një përmirësim është vërejtja në libër që duhet shkruar se është bërë përmirësimi apo ndërhyrja dhe të nënshkruhet.

Por, zakonisht nuk preferohet të përdoret llak në libra. Edhe unë jam shumë i bindur që në librat të cilat i kam dorëzuar nuk ka përmirësime. Ju mundeni me i pa në Ministrinë e Drejtësisë.” “Ju keni mundur t’i shikoni dosjet dhe librat që i kam mbajtur unë, nuk mundesh me gjet asnjë emër të dikujt që ka pasur intervenim me llak.”

Sahit Shala është larguar së bashku me punëtorët e tjerë menjëherë pas përkrahjes së deklaratës se 2 korrikut 1990. Kanë kaluar mbi 27 vite që nga koha kur janë vendosur masat e dhunshme në Kosovë. Por, është fakt i pakontestueshëm që Sahit Shala është larguar nga puna nga masat e dhunshme të vendosura nga aparati shtetëror jugosllav në kohën kur janë larguar shumica e shqiptarëve 1989/90/91.

Është fakt i parëndësishëm nëse Sahit Shala ka bërë përmirësime të njëjta. Prokurori i rastit, dëshmitari Shala vërehet se i qaset në mënyrë selektive. Deklaratat që shkojnë në favor të

mbylljes së rastit i merr si të mirëqena duke e konsideruar Shalën si dëshmitar të besueshëm, përderisa në rastet kur dëshmia e tij bie zbulon veprime të kundërligjshme të ndërhyrjes në dosje të Lumezit, dëshmitarin Shala e konsideron si një person të luhatshëm dhe i cili i ndërron deklaratat e tij. Dëshmitari nuk mund të jetë i besueshëm dhe i pabesueshëm për pjesë të caktuara të deklaratave. Prokurori vendos t'ia fal ose mos t'ia fal besimin dëshmisë së tij.

Sahit Shala është ftuar për tu intervistuar tre herë në prokurori lidhur me të njëjtën çështje, në cilësi të dëshmitarit.

Siç shihet edhe më lartë, Sahit Shala, ka deklaruar se nuk e mban mend që ka bërë përmirësime me llak. Pas prezantimit të librave, sipas Shalës, iu ka kujtuar se ka bërë një numër të vogël të përmirësimeve, duke i arsyetuar ato me gabime njerëzore dhe duke i sqaruar si psh rastin e Biljana Rexhiqit. “Asaj i është shkruar emri në cirilikë dhe pas ankesës së saj se ajo është shqiptare dhe se nuk pranon që t’i figurojë emri në cirilikë, Shala thotë se ka vendosur ta përmirësojë, duke e lyer me llak dhe duke e vendosur emrin e njëjtë të saj në alfabetin latin. Kjo ka ndodhur dhe ka mundur që ndonjëherë të gabohet ndonjë shkronjë ose ndonjë numër dhe i njëjti të përmirësohet, por assesi nuk ka ndodhur që mbi emrin e dikujt, të shkruhet një emër tjetër, siç ka ndodhur në rastin Lumezi”.

Sahit Shala është ftuar tre herë nga Prokuroria dhe Policia në intervistë në cilësinë e dëshmitarit. Gjatë intervistës së transmetuar në emisionin “Betimi për Drejtësi” në RTK dhe në lajmet qendrore të KTV vërehet qartë se Sahit Shala ka qenë i relaksuar, dhe iu është përgjigjur pyetjeve në bazë të informatave dhe njohurive të tij nga përvoja dhe praktika shumëvjeçare.

Gjithë publiku ka pasur dhe ka mundësi ta shohë intervistën e plotë të zhvilluar dhe mënyrën e intervistimit.

Pas këtij konstatimi të deklaratës së Sahit Shalës në aktvendimin për hedhjen e kallëzimit penal, ekipi i hulumtuesve, ka takuar sërish z. Shala, të cilin e ka pyetur për këtë pjesë të deklaratës të dhënë në polici. Ai ka mohuar kategorikisht çdo mundësi që të ketë deklaruar se është lajthitur nga gazetarët. Deklaratën, sipas tij, nuk e ka lexuar sepse nuk ka pasur asnjëherë syze me vete, por deklaratën që ia ka ofruar policia e ka nënshkruar.

3) Dëshmitari Sahit Shala (dëshmia e tretë)

Me datë 06.11.2017, është investuar Sahit Shala, në cilësi të dëshmitarit, i cili ka deklaruar:

“Kam bërë përmirësime, por as unë nuk kam shënuar në katrorin ku shënohen vërejtjet, edhe pse është dashur të shkruhen. Sa i përket Sekretarit Krahinor për Judikaturë, Djordje Aksic, i cili në dosjen e Lumezit ka nënshkrim si anëtar i komisionit, kjo nuk ka qenë praktike gjatë punës time dhe mendoj që është konflikt i interesit.

Për paraqitjen e provimit të Judikaturës nuk ka pasur afat të caktuar. Ne kemi përpiluar lista të kandidatëve të cilët i nënshtrohen provimit, mirëpo këto lista nuk i kemi ruajtur, pasi që nuk kanë pasë rëndësi të veçantë”.

Sa i përket pyetjes se a ka mundur kandidati që ta paraqes provimin para se ta plotëson kushtin prej një viti të punës praktike. Dëshmitari u përgjigj: “Ka mundur, nëse ky kandidat para hyrjes

në provim, përkatësisht para vendimit për lejimin e hyrjes në provim, ka sjellë dëshminë se e ka kryer praktikën prej një viti dhe kësaj ai i ka plotësuar kushtin prej një viti të praktikës, para nënshtrimit të provimit të Judikaturës”.

Dëshmitarit i është prezantuar dosja me procesverbalin e dhënies së provimit të Judikaturës, me numër 02/152-1-217/90, e kandidatit Aleksandër Lumezi, dosje kjo e cila përmbante mbështjellësin dhe dy fletë me katër faqe, duke e pyetur se çka mendon për këtë dosje.

Dëshmitari u përgjigj: “mungojnë punimet me shkrim, dokumentet për lejimin e provimit (vërtetimi mbi përvojën e punës, kopja e vërtetuar e diplomës, aktvendimi mbi lejimin e provimit) ndërsa sa i përket tjerave mendoj se është gjithçka në rregull.(faqe 7 e Aktvendimit)

IKD: Dëshmitari Sahit Shala në këtë pjesë të deklaratës, të cilën e ka bazuar në njohuritë dhe përvojën praktike të punës si ish-Sekretar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, përputhet plotësisht me dispozitat dhe praktikën e zbatimit të ligjit, të cilat atëherë dhe tash nuk lejojnë që aso kohe Sekretari Krahinor (ekuivalent me pozitën e Ministrit të Drejtësisë) të jetë edhe anëtar i Komisionit, i cili pyet kandidatët në provim.

Kjo paraqet konflikt të interesit. Një gjë e tillë ka ndodhur sipas procesverbalit të dosjes së Aleksandër Lumezit, ku Djordje Aksiq shkruan se është anëtar i Komisionit dhe poashtu Sekretar Krahinor, i cili e ka nënshkruar certifikatën për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Deklaratat e Sahit Shalës dhënë për emisionin “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavision, se kandidati nuk ka pasur mundësi ta paraqesë provimin e jurisprudencës pa e pasur vërtetimin për përfundimin e punës praktike njëvjeçare mbështeten në dispozitat e Ligjit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

Kjo deklaratë bie në kundërshtim edhe me vet Nenin 7 të Ligjit për dhënien e provimit të jurisprudencës që përcaktonte se kërkesa për dhënien e provimit të jurisprudencës i paraqitet organit krahinor të administratës kompetente për punët e jurisprudencës. Bashkë me kërkesën kandidati kishte për obligim që të vërtetonte se kishte kryer fakultetin juridik dhe vërtetimin mbi plotësimin e kushteve për dhënien e provimit të jurisprudencës. Vërtetimi sipas ligjit nuk mund të jepej pa pasur një vit përvojë praktike në prokurori apo gjykatë.

Gjithashtu, sipas kësaj deklaratë të Shalës dhënë në Polici, e cila bie në kundërshtim me deklaratat e bëra në intervistë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, rezulton se Aleksandër Lumezi ka mundur që deri në kohën e lëshimit të vendimit për lejim në provim të jurisprudencës, ta ofrojë vërtetimin e punës praktike njëvjeçare. Sidoqoftë, edhe kjo nuk ka relevancë, bazuar në deklaratën e dhënë nga vetë Kryeprokurori Aleksandër Lumezi, i cili ka deklaruar në prokurori se gjithë dokumentacionin e tij e ka prezantuar në të njëjtën kohë për ta paraqitur provimin e jurisprudencës.

Hulumtimi dëshmon se përkundër obligimeve ligjore dhe praktikës së punës së Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, në Arkivin e Kosovës, në dosjet e jurisprudencës nuk gjenden dokumentet, të cilat i ka përmendur dëshmitari Sahit Shala. Aty mungojnë punimet me shkrim, dokumentet për lejimin e provimit (*vërtetimi mbi përvojën e punës, kopja e vërtetuar e diplomës, aktvendimi mbi lejimin e provimit*).

Sa i përket tjerave, nuk janë në rregull, bazuar në ligj dhe vetëintervistën e dhënë nga Sahit Shala. Në vazhdim është përshkruar procesverbali i provimit të Aleksandër Lumezit, shkeljet ligjore dhe ndërhyrjet me llak.

Faqja e parë e mbështjellësit të dosjes bazë të Aleksandër Lumezit është e manipuluar me ndërhyrje të llakut të bardhë. Në këtë faqe të vulosur në sipërme të majtë, shkruan data e paraqitjes së provimit 17.10.1990, njësia organizative me numër 02/152-1-217/90. Në anën e djathtë shkruan shenja e klasifikimit 152. Lënda shkruan në latinicë Aleksandar Ljumezi. Tek kjo pjesë e lëndës dosja është e manipuluar me ndërhyrje të llakut të bardhë, mbi të cilën është shkruar Aleksandar Ljumezi. Nën llakun e bardhë nën vëzhgimin e dritës, vërehet i shkruar në cirilikë emri Zymer Krasniqi. Më poshtë evidentohet afati i ruajtjes që shkruhet në cirilikë përgjithmonë. Evidentohet numri nga libri intern 1146. Krejt në fund në anën e majtë shkruan në cirilikë vendi – Prishtinë dhe data e mbylljes së dosjes 09.05.1991. Dhe në anën e djathtë në fund është nënshkrimi i përgjegjësit që e ka përpunuar lëndën. Prokuroria nuk e ka siguruar aktvendimin për ta prezantuar para publikut, i cili ia lejon Aleksandër Lumezit nënshkrimin në provim.

Në faqen e parë të procesverbalit të provimit, sërish në anën e majtë është vula me detajet e njëjta sikurse në mbështjellës të dosjes, ku evidentohet njësia organizative me numër 02/152-1-217/90 dhe data 27 shkurt 1991.

Titulli kryesor shkruan “Regjistri për dhënien e provimit të jurisprudencës”. Tutje shkruan para Komisionit pyetës të lejuar me vendimin e Sekretariatit Republikan për Administratë dhe Jurisprudencë të datës, 30 tetor 1990, e ka dhënë provimin e jurisprudencës Aleksandër Ljumezi me punë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Dhënia e provimit është lejuar sipas vendimit të këtij sekretariati me numër 152-1-217 të datës 11 shkurt 1991. Provimi është dhënë për herë të parë. Provimin me shkrim e ka kaluar me 25 dhe 26 shkurt 1991. Në provimin me shkrim ka pasur detyrat nga:

- E drejta civile - Vendimi sipas kërkesës së akuzës;
- E drejta penale - Aktakuza.

Sipas këtij regjistri në të drejtën civile ka qenë pyetja: Vendimi sipas kërkesës së akuzës. Sipas Sahit Shalës, ish-Sekretar i Komisionit për Provim të Jurisprudencës nuk ka pasur mundësi as sipas ligjit e as nuk ka qenë praktikë që në të drejtën civile të parashtrihen pyetje nga e drejta penale.

Sipas tij pyetjet në të drejtën penale janë të ndara. Sipas dosjes së Lumezit herën e parë e ka pasur pyetjen nga e drejta penale - Akti Akuzues.

Në faqen dy të procesverbalit, hapësira ku shkruhet data e dhënies së provimit me gojë ka mbetur e zbrazët. Sipas Shalës ka qenë obligim ligjor dhe praktikë të evidentohet data se kur është mbajtur provimi me gojë, që në rastin e Aleksandër Lumezit nuk ka ndodhur.

Në bazë të faqes dy dhe tre të procesverbalit të provimit, rezulton se Lumezi iu ka nënshtruar provimit në këto lëndë: sistemi kushtetues dhe organizimi i gjyqësisë, e drejta penale, e drejta civile, e drejta ekonomike, e drejta e punës dhe e drejta administrative. Në fund të faqes tre,

anëtarët e Komisionit, të cilët janë nënshkruar, kanë konstatuar se Aleksandër Lumezi ka mbetur në riprovim në dy lëndë: e drejta civile dhe e drejta ekonomike. Gjë që rezulton se ka qenë në rregull.

Por, në faqen e fundit të procesverbalit të provimit, shkruan se Aleksandër Lumezi iu është nënshtruar riprovimit më 24 prill 1999, në ora 15:00 në dy lëndë tjera dhe jo ato që janë evidentuar në faqen 3. Këtu evidentohet se Lumezi i është nënshtruar provimit me shkrim dhe me gojë nga e drejta penale, ku e ka pasur detyrën aktgjykimi dhe e drejta civile ku e ka pasur detyrën vendimi.

Sipas ligjit të atëhershëm mbi dhënien e provimit të jurisprudencës, kandidatët nuk kanë mundur që të mbesin në riprovim në të drejtën penale edhe atë civile, si dy lëndë bazike.

Nëse Lumezi ka mbetur në riprovim vetëm në të drejtën civile dhe ekonomike, atëherë Lumezi nuk ka pasur nevojë të hynte në riprovim në të drejtën penale.

Gjithashtu, nuk ka përputhje të pyetjeve në provim dhe riprovim, te lënda e drejta penale, të cilën Lumezi, sipas procesverbalit rezulton se e ka dhënë në afatin e parë me shkrim. Nëse kjo do të ishte e saktë, atëherë në procesverbal më rastin e evidentimit të pyetjeve të riprovimit, në të drejtën penale, do duhej të figuronte pyetja e njëjtë. Në rastin e Lumezit, herën e parë shkruan se në të drejtën penale e ka pasur pyetjen – akti akuzues, të cilin figuron se e ka dhënë. Ndërsa, në riprovim figuron se e ka pasur një pyetje tjetër nga e drejta penale, përkatësisht aktgjykimi. Kjo nuk ka logjikë dhe bie në kundërshtim me ligjin dhe praktikën e procedurave për dhënien e provimit të jurisprudencës. Në këtë skenar, del se Lumezi dy herë ka hyrë në provimin e së drejtës penale dhe se dy herë e ka dhënë.

Tutje, shkruan se pjesën e provimit me gojë e ka përfunduar më 26.04.1991 në orën 15:00, në lëndët si në vijim: e drejta civile, ku janë parashtruar pyetjet “rendi i parë i trashëgimisë” dhe “aktgjykimi në bazë të pranimit”. Në pyetjet nga e drejta civile, sërish rezulton se ka pasur ndërhyrje me llak të bardhë dhe mbi to janë shkruar pyetjet ekzistuese. Ndërsa nga e drejta ekonomike, janë parashtruar pyetjet “efektet e falimentimit” dhe “veprimet e kambialit”.

Dhe në fund shkruan se me vendim të Komisionit, kandidati e ka dhënë provimin e jurisprudencës, pas të cilit janë nënshkruar përgjegjësit e Sekretariatit dhe anëtarët e Komisionit.

Shënimet e procesverbalit nuk përputhen me certifikatën e prezantuar nga vetë Lumezi. Në certifikatë shkruan se provimi është kryer më 25 prill 1991 e jo më 26 prill 1991 në ditën kur sipas dosjes Lumezi ka kaluar provimin.

Krejt në fund në procesverbal gjithashtu figuron Gjorgje Aksiq si njëri nga anëtarët e Komisionit, i cili aso kohe kishte qenë edhe Sekretar Krahinor – ekuivalent me Ministrin e Drejtësisë tash. Kjo nuk lejohet me ligj dhe paraqet konflikt interesi që Ministri, i cili bën emërimin e anëtarëve të Komisionit, të jetë edhe anëtarë i Komisionit.

Dëshmitari Sahit Shala është ftuar tri herë në polici dhe prokurori për intervistë, pas pasur aktvendim për fillim të hetimeve.

4) Dëshmitari Radislav Dimitrijevic (dëshmia e parë)

Më datë 27/10/2017, për interviste është ftuar dëshmitari Radislav Dimitrijevic, i cili ka qenë, Sekretar i Komisionit të Judikaturës në kohën kur Aleksandër Lumezi (Kryeprokuror i Shtetit) i është nënshtruar provimit të Judikaturës.

Dëshmitarit i është prezantuar dosja e kandidatit Aleksandër Lumezi, dhe është pyetur nëse kjo dosje është punuar nga ai. Me të pa dosjen dëshmitari ka thënë: “Po këtë dosje e kam plotësuar unë në këtë pjesë duke ju referuar mbështjellësit, është nënshkrimi im, emri dhe mbiemri i kandidatit është shkrimi im, ndërsa nën emrin e kandidatit tash po me kujtohet është shkrimi i koleges sime të ndjerë Natalija Kovacevic, me të cilën kam punuar në të njëjtën zyre, ndërsa procesverbali është 99% i imi, në faqen e dytë dhe të tretë, në katër pyetjet është shkrimi im dhe nënshkrimi im, ndërsa në faqen e katërt siç shihet kandidati ka mbet në riprovim dhe çdo gjë është në rregull”.

Gjithashtu, dëshmitari ka thënë: “korrektuesi është përdorur, mirëpo jo në certifikatën e provimit të judikaturës sepse nëse ka pasur korrektim Kryetari i Komisionit nuk e ka nënshkruar, ndërsa sa i përket regjistrave tjerë ka mundur të ndodhë ndonjëherë, në raste të rralla”, duke shtuar se: “më ka ndihmuar në plotësimin e shkresave edhe Natalija Kovancevic, e cila ka punuar me një zyre me mua”.

Sipas dëshmitarit, deri te përmirësimi i mbështjellësit të kandidatit Aleksandër Lumezi, ka ardhur si pasojë e ndonjë gabimi teknik që ka mundur ta ketë bërë kolegia e tij Natalija, e cila derisa ka plotësuar të dhënat e kandidatit dhe i ka përputhur me procesverbalin, ka vërejtur që ka gabuar. (faqe 3 e Aktvendimit)

IKD: Rade Dimitrijevic ishte caktuar në pozitën e Sekretarit të Komisionit të Judikaturës me vendim të organeve të dhunshme dhe ishte vendosur në pozitën e Sahit Shalës, i cili ishte përjashtuar nga puna së bashku meshumicën e shqiptarëve në atë kohë.

Pyetjet që shtrohen nga publiku janë këto:

- Si ka pasur mundësi që të gjithë dosjen (përfshirë mbështjellësi i jashtëm dhe procesverbali në brendi) ta plotësojë Radislav Dimitrijevic, ndërsa vetëm emrin e kandidatit ta shkruajë kolegia e tij Natalija Kovacevic (tani e ndjerë)?
- Sipas kësaj deklaratë, rezulton se Natalija Kovacevic e ka plotësuar vetëm emrin e Zymer Krasniqit, të cilin e ka shkruar gabimisht, ndërsa gjithë dosjen e ka plotësuar Radislav Dimitrijevic. Si ka mundësi që vetëm emrat i paska shkruar Kovacevic në dosje dhe jo gjitha të dhënat?
- Duke njohur faktin se mbi Zymer Krasniqin është vendosur llak dhe mbi të është shkruar Aleksandër Lumezi si ka pasur mundësi dëshmitari ta vërejë se shkrimi kishte qenë i koleges Natalija Kovacevic, gjithnjë duke u bazuar në faktin se me shumë vështirësi arrin të shihet shkrimi i Zymer Krasniqit në cirilikë dhe atë vetëm pas dritës së madhe të hedhur mbi të?
- Pse i njëjti gabim ka ndodhur pothuajse në të gjithë dosjen ku gjendet emri i Aleksandër Lumezit?

- Nëse gabimi është identifikuar duke u bazuar në të dhënat e procesverbalit të Aleksandër Lumezit dhe është bërë përmirësimi i emrit dhe mbiemrit në mbështjellësin e dosjes dhe librin e regjistrimit të paraqitjes së provimit, pse nuk është bërë përmirësimi i datës së përfundimit të provimit, i cili në procesverbal shkruan 26 prill 1991, ndërsa në certifikatë të prezantuar nga Lumezi shkruan se provimin e ka përfunduar me 25 prill 1991?

Dëshmitari ka deklaruar se në faqen e katërt Lumezi ka mbetur në riprovim dhe se çdo që është në rregull. Bazuar në dispozitat ligjore aso kohe dhe sipas intervistës së ish-Sekretarit të Komisionit të Provimit të Jurisprudencës, Sahit Shala, përmbajtja e procesverbalit të Aleksandër Lumezit është në kundërshtim me ligjin dhe nuk përputhen askund të dhënat e rubrikave rreth pyetjeve dhe provimeve. Kjo pjesë e shkeljeve është analizuar më lartë, shih faqet: 35, 36 dhe 37 të këtij raporti.

Njëjtë si dëshmitarët tjerë, edhe Radislav Dimitrijevic është ftuar si dëshmitar pa pasur aktvendim për fillimin e hetimeve.

Sipas dëshmitarëve, korrektuesi i llakut të bardhë edhe mund të jetë përdorur atë kohë por dhe më vonë. Por, ka pasur rregulla të përcaktuara për përdorimin e korrektuesit dhe vërejtja, e cila është dashur të evidentohet për të arsyetuar përdorimin e tij.

5) Dëshmitari Radislav Dimitrijevic(dëshmia e dytë)

Me datë 31.10.2017, përsëri është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit Radislav Dimitrijevic. Gjatë intervistës i njëjti ka deklaruar: “procedura e paraqitjes së provimit të juridikaturës dhe provimit për gjyqtar për kundërvajtje ka qenë e njëjtë, mirëpo paraqitja e provimit për gjyqtar për kundërvajtje është regjistruar në libër tjetër të veçantë, mbështjellësi i këtij provimi si për jurisprudencë dhe gjyqtar për kundërvajtje ka qenë i njëjtë”.

Dëshmitarit i është prezantuar dosja e Aleksandër Lumezit. Dëshmitari me të pa dosjen deklaroi: “Kjo që po më prezantohet është vetëm provë që i njëjti e ka dorëzuar kërkesën dhe ne e kemi pranuar. Ndërsa tjetri dokument-procesverbal, këtë e kam punuar unë”. I njëjti i ka identifikuar dy anëtarët e komisionit, Gjorgje Aksiq, profesor i Fakultetit Juridik, dhe kryetarin e komisionit, i cili ka qenë Vukashin Jakanoviq. Kandidati si dëshmi që ka paraqitur provimin ka marr një vërtetim që ka dorëzuar kërkesën-dokumentacionin. (faqe 4 e Aktvendimit)

IKD: Edhe hulumtimi dëshmon se ekzistojnë tri libra të paraqitjes së provimeve (provimi i jurisprudencës, provimi për gjykatës për kundërvajtje dhe provimi profesional). Hulumtimi dëshmon se Aleksandër Lumezi ka figuruar vetëm në librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës dhe atë mbi emrin e Zymer Krasniqit. Ndërkohë, pas mbylljes së hetimit, Prokuroria ka publikuar edhe dy libra të tjerë. Aleksandër Lumezi figuron se i ka paraqitur dy provime. Nga hulumtimi ka rezultuar kjo gjendje:

- Për herë të parë Lumezi e ka paraqitur provimin e jurisprudencës, por vetëm mbi dosjen e Zymer Krasniqit ku evidentohet data 17 tetor 1990.

- Për herë të dytë Lumezi e ka paraqitur provimin profesional, ku evidentohet data 9 janar 1991.
- Zymer Krasniqi figuron se e ka paraqitur provimin e jurisprudencës me datën 17 tetor 1990, por që është fshirë dosja e tij me llak dhe është shkruar Aleksandër Lumezi.
- Në librin e paraqitjes provimit për gjykatës për kundërvajtje figuron kandidati Zimer Krasniqi nga Prishtina, i cili e ka paraqitur provimin më 11 janar 1991.
- Nuk dihet nëse bëhet fjalë për të njëjtin person, siç ka konstatuar prokuroria, sepse janë dy emra dhe dy vendlindje të ndryshme. Zymer Krasniqi është nga Deçani, ndërsa Zimer Krasniqi është nga Prishtina.
- Pyetja që do përgjigje nga publiku prej Prokurorisë është se përse Aleksandër Lumezi e ka paraqitur edhe provimin profesional, përveç provimit të jurisprudencës?
- Pse Aleksandër Lumezi u shkrua mbi dosjen e Zymer Krasniqit dhe vetëm në bazë të të dhënave të kësaj dosje përputhet gjithçka me certifikatën e provimit të prezantuar nga Lumezi?
- Të gjitha këto dilema në procedurë penale eliminohen vetëm duke bërë ekspertizë grafologjike të të gjitha këtyre dokumenteve të manipuluar me llak të bardhë.
- Në fund thuhet se, “kandidati si dëshmi që ka paraqitur provimin ka marr një vërtetim që ka dorëzuar kërkesën-dokumentacionin”. Kjo kërkesë nuk është prezantuar dhe nuk dihet se për çka është fjala ?

Prokuroria duhet ta dëshmojë në publik çka është kjo kërkesë e dorëzuar dhe pranuar?

6) Dëshmitari Radislav Dimitrijevic (dëshmia e tretë)

Me datë 07/11/2017 kemi intervistuar Radislav Dimitrijevic-in, sa i përket dilemave në data(24-26Prill 1991)dhe pjesmarrjes së Sekretarit Krahinor për Jursiprudencë Djorgje Aksic , i cili njëherit ka qenë edhe anëtar i komisionit, dëshmitari ka deklaruar:

“Sa i përket datave të riprovimit 24-26 viti 1991, gjithçka është në rregull. Ndërsa sa i përket faqes së riprovimit (faqe 4) te pjesa ku kandidati i nënshtrohet riprovimit, në formular shkruan Gradjansko pravo dhe Krivicno pravo, ka qenë gabimi im së është dashtë që ti bie vijë ku shkruan e drejta penale dhe në vend të saj të shkruaj e drejta ekonomike, dua të shtoi se të gjithë formularët kanë qenë të njëjtë dhe shumica e kandidatëve kanë mbetë në riprovim nga lënda penale dhe civile”.

Certifikata me datën 25/04/1991 është lëshuar duke u bazuar në të dhënat e Librit për dhënien e provimit te Judikaturës, ndërsa data 26.04.1991, që figuron në Procesverbal mund të jetë gabim teknik i imi, sepse është e logjikshme se provimi ka zgjatë më shumë se një ditë sepse kemi pasur shumë kandidat dhe për këtë arsye unë kam mundur ta regjistroj datën 26.04.1991, e kandidati i është nënshtruar dhe ka dhënë provimin me 25.04.1991.

Sa i përket Djorde Aksic-it, ai ka pasur autorizimin ti nënshkruaj procesverbalet edhe pse ka qenë epror po të njëjtën kohë, ka qenë edhe anëtar i komisionit.

Djorde Aksic ka marrë pjesë në provim të Judikaturës dhe i ka pyetur kandidatët në të drejtën penale” (faqe 9 e Aktvendimit)

IKD: Radislav Dimitrijevic cili ka punuar gjatë masave të dhunshme, në deklaratën e tij para prokurorit pranon se ka bërë gabime.

Edhe sipas Ligjit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës të asaj kohe kandidatët kanë mundur të mbesin në ri-provim ose në të drejtën penale ose në të drejtën civile. Ligji nuk e ka lejuar që në ri-provim të mbesin kandidatët në të njëjtën kohë edhe në të drejtën penale dhe në civile.

Është fakt notor në atë kohe dhe edhe tani se kandidatët që mbesin në riprovim mbesin ose në penale ose në civile si lëndë kryesore.

Pyetjet kryesore në këtë pjesë të dëshmisë së këtij dëshmitari janë si vijon:

- Si ka mundësi që gjithë këto gabime të jenë bërë të kandidati Aleksandër Lumezi?
- Nëse këto gabime janë bërë nga Dimitrijevic, si janë lejuar të njëjtat gabime të aprovohen nga anëtarët e Komisionit në procesverbal?
- Si ka mundësi që të gjithë anëtarët që në fund kanë vendosur nënshkrimet e tyre, asnjëri të mos i vërejë këto gabime, të cilat nuk lejohen me ligj të ndodhin?

Prokurori Munishi nuk ka mundur të vërtetojë në Aktvendim për hedhje të kallëzimit penal se pse në dosjen e Aleksandër Lumezit ka aq shumë gabime. Pothuajse në çdo dokument të tij ka gabime. Dhe këto gabime janë bërë ose nga Radislav Dimitrijevic që e pranon në deklaratë ose nga e ndjera Natalija Kovacevic. Gabimet janë përmirësuar me korrektor.

Pse Prokurori Munishi për të vërtetuar dhe zbardhur këtë rast përtej dyshimit të bazuar, nuk ka kërkuar ekspertizën e dosjeve, në përputhje me obligimet që dalin nga KPP . Zbatimi i këtij obligimi ligjor, respektivisht ekspertimi i dokumenteve do të zbulonte të vërtetën dhe do të evitonte çdo dyshim lidhur me dosjen e manipuluar të Kryeprokurorit Lumezi. Në veçanti e diskutueshme është se pse nuk është dërguar asnjë dokument i manipuluar me korrektor – llak në ekspertizë?

7) Dëshmitari Miladin Kostic

Me datën 08.11.2017, është intervistuar Miladin Kostic, anëtar i Komisionit të Judikaturës, në vitin 1990-91, i cili ka deklaruar:

“Në vitin 1990-1991, kam qenë profesor në Fakultetin Juridik në Prishtinë, e kam pasë edhe detyrën e sekretarit të Fakultetit, gjithashtu kam qenë anëtar i Komisionit për dhënien e Provimit të Judikaturës, në provimin e Judikaturës kanë qenë Vukasin Jokanovic, të drejtën Kushtetuese dhe Organizimin e Gjykatave, Mirko Perunovic ka pyet të drejtën Ekonomike, i cili ka vdekur diku para 6 -8 muaj, Djorde Aksicka pyet të drejtën Penale, Ljubomir Popovicka pyete te drejtën Civile, ndërsa unë kam pyet të drejtën Administrative dhe te drejtën e Punës, sekretar i komisionit ka qenë Rdislav Dimitrijevic. Anëtarë i provimit të Judikatures kam qenë nga 1991 deri 1993 ose 1994, aq sa me kujtohet.”

Dëshmitarit i është prezantuar dosja e provimit të Judikaturës së kandidatit Aleksandër LUMEZI, dhe pyetet nëse është në gjendje për ta identifikuar ndonjë shkrim apo nënshkrim nëse është i tij.

Dëshmitari përgjigjet: Po unë jam në gjendje për ta njohur dhe identifikuar shkrimin tim, i cili është në pikën 5, ku unë i kam shkruar me dorën time dy pyetje dhe në pikën e 6, unë i kam shkruar me dorën time dy pyetje, gjithashtu nënshkrimi në faqen e tretë dhe në faqen e 4 është nënshkrimi im. Kandidati herën e parë ka mbetë në provim dhe në riprovim e ka kaluar provimin e Judikaturës, ku unë e kam nënshkruar këtë procesverbal dhe kjo është e pakontestuar që kandidati e ka dhënë provimin e Judikaturës.

Procesverbali i provimit është i pakontestueshëm, këtë po e shoh dhe nuk kam asnjë dilemë sa i përket vërtetësisë së tij dhe çdo gjë është në rregull, mbështjellësi nuk është i rëndësishëm, sepse pjesa kryesore procesverbali është i pakontestueshëm dhe çdo gjë është në rregull. Mbështjellësi nuk ka rëndësi, sepse këtë e ka punuar sekretari dhe ai ka mundur të bëjë ndonjë gabim teknik, pjesa me rëndësi edhe një herë po e cekim është procesverbali ku nënshkruhen të gjithë anëtarët e komisionit dhe nuk ka asnjë ndërhyrje ose përmirësim dhe është shkruar dhe nënshkruar nga unë dhe anëtarët tjerë të komisionit. Në këtë procesverbal është nënshkrimi i Mirko Perunovic, Ljubomir Popovic, Djorđe Aksic dhe Vukasin Jokanovic dhe siç shihet edhe në faqen 3 dhe 4 janë nënshkrime identike pasi që janë bërë në kohë të ndryshme”.

Se a ka pasur të drejtë Djorđe Aksic që të jetë edhe Sekretar Krahinor për Judikaturë edhe anëtar i komisionit për dhënien e provimit të Judikaturës, dëshmitari thotë: “Djorđe nuk e ka emëruar veten si anëtar, por këtë emërim e ka bërë Sekretariati Republikan dhe çdo gjë ka qenë në rregull “.

Sa i përket datave 24 dhe 26 Prill, 1991, dëshmitari thotë: “në procesverbal në fillim faqen e 4 janë të evidentuara datat 24 dhe 26 prill, kur kandidati e ka kryer provimin me shkrim nga e drejta civile, ndërsa provimin me gojë ka mundur me dhënë me datë 25 apo 26, gjë që nuk është e rëndësishme, meqenëse kandidati e ka dhënë provimin e judikaturës që vërtetohet edhe me nënshkrimet e anëtarëve dhe kryetarit të komisionit”. (faqe 10 Aktvendimit))

IKD: Miladin Kostic bazuar në hulumtimin e emisionit “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavision në bibliotekën kombëtare dhe gazetave zyrtare, rezulton se ishte emëruar në Komisionin për provim të jurisprudencës së bashku me zyrtarët e Sekretariatit Krahinor të Juridikaturës gjatë masave të dhunshme në Kosovë.

Kostic në deklaratë vetëm konfirmon nënshkrimin e tij, shkrimin e tij sipas dokumenteve të paraqitura nga prokurori Munishi. Sipas Kodit Penal të Kosovës, prokurori Munishi nuk ka pasur të drejtë tamarrë në pyetje Kosticin pa avokat mbrojtës. Nëse Kostic do të deklaronte ndryshe nga ajo që e deklaronte do të inkriminonte vetën në veprë penale. Nëse Kostic do të deklaronte se Lumezi nuk eka kryer provimin e jurisprudencës, atëherë i njëjti do të duhej të arsyetonte veprimet e tij inkriminuese në falsifikimin e provimit të jurisprudencës.

Sidoqoftë, deklarata e Kosticit në tërësi është kundërtënëse dhe nuk përputhet me shkeljet ligjore të evidentuara në procesverbal. Për më tepër, në procesverbal ka ndërhyrje me llak, ndërsa të njëjtat nuk janë vërejtur nga Kostic dhe hetuesit e policisë. Shkeljet në evidentimin e

provimeve, detyrave dhe datave janë në kundërshtim me ligjin dhe praktikën dhe përkundër faktit se ish-Sekretari i Komisionit, Radislav Dimitrijevic e ka pranuar se ka bërë ndërhyrje me llak për të përmirësuar gabimet, Kostic nuk i pranon ato. Për më tepër rreth të gjitha shkeljeve dhe ndërhyrjeve me llak në procesverbalin e provimit të Lumezit, shih analizën në faqet: 35, 36 dhe 37 të këtij raporti.

Pyetjet me rëndësi lidhur me dëshminë e këtij dëshmitari e të cilat publiku pret përgjigje në to janë si vijon:

- Si ka mundësi që Radislav Dimitrijeviq po i pranon gabimet në procesverbal, ndërsa Kostic thotë se nuk ka asnjë problem dhe se gjithçka është në rregull?
- A e kanë parë të njëjtin procesverbal, i cili është publikuar dhe ku shihen gabimet në shënime dhe ndërhyrjet me llak apo ndonjë tjetër pa ndërhyrje?
- Kostic ka deklaruar se nuk është e rëndësishme a e ka dhënë kandidati provimin me gojë me 25 a më 26 prill 1991. Data e dhënies së provimit figuron si datë zyrtare në certifikatë. Aleksandër Lumezit i shkruan data 25 prill 1991 që e ka dhënë provimin, ndërsa në procesverbal shkruan se e ka dhënë provimin më 26 prill 1991, në orën 15:00. Si nuk është e rëndësishme data e kryerjes së provimit, kur ajo figuron në certifikatë dhe në çdo evidencë zyrtare?

Sa i përket Gjorgje Aksiqit, i cili ka qenë edhe anëtar edhe Sekretar Krahinor, që bie në kundërshtim me ligjin, Kostic ka deklaruar se emërimin e Aksiqit si anëtar të Komisionit e ka bërë Sekretariati Republikan dhe se gjithçka ka qenë në rregull.

8) Dëshmitari Zymer Krasniqi

Me 31.10.2017 është dëgjuar dëshmitari Zymer (Krasniqi) Tahiri, emri i të cilit ishte fshirë dhe mbi të cilin ishte shkruar emri i kandidatit Aleksandër Lumezit, në dosjen e paraqitjes së provimit të Jurisprudencës.

Dëshmitari ka deklaruar. “Unë nuk kam vazhduar ndonjë edukim, por pas përfundimit të praktikës së punës në Gjykatën për Kundërvajtje prej një viti, kam marrë vërtetimin në Gjykatën për Kundërvajtje në Deçan, që dëshmon se e kam kryer praktikën, pastaj kam marrë diplomën e Fakultetit Juridik, pastaj dokumente tjera që është dashur në atë kohë dhe aq sa më kujtohet ka qenë kah fundi i nëntorit të vitit 1990, kur kam ardhur në Prishtinë dhe kam shkuar për ta paraqitur provimin, atë kohë kanë qenë Organet e Administratës për Judikaturës, përballë Muzeut në Prishtinë. Mua mi ka pranuar këto dokumente një zyrtar serb dhe ma ka lëshuar vërtetimin si dëshmi që e paraqita provimin, ky person me tha që është çdo gjë në rregull dhe do ta dërgojnë ftesën kur mbahen provimet”. (faqe 4 e Aktvendimit)

Dëshmitari ka deklaruar se nuk është i sigurt se cilin provim e ka paraqitur, të Judikaturës apo për Gjyqtar për Kundërvajtje.

Dëshmitarit nuk i kujtohet se ka marrë vërtetimin mbi lejim e hyrjes në provim, nuk i kujtohet komisioni, nuk i kujtohen pyetjet dhe **nuk e di nëse e ka dhënë apo jo provimin e judikaturës.** (faqe 5 e Aktvendimit)

IKD: Hulumtimi dëshmon gjithë deklaratën e Zymer Krasniqit se e ka përfunduar punën praktike një vjeçare në ish-Gjykatën Komunale të Kundërvajtjes në Deçan dhe se më datën 12 tetor 1990 ka marrë vërtetimin e gjykatës për ta paraqitur provimin për gjykatës për kundërvajtje. Në dosjen e Zymer Krasniqit, mbi të cilën është shkruar mbi llak Aleksandër Lumezi, del se Zymer Krasniqi e ka paraqitur provimin 5 ditë pasi e kishte nxjerrë vërtetimin, përkatësisht më 17 tetor 1989.

Kjo përputhet afërsisht edhe me kohën për të cilën Krasniqi ka deklaruar në polici, ku thotë se “dhe aq sa më kujtohet ka qenë kah fundi i nëntorit të vitit 1990, kur kam ardhur në Prishtinë dhe kam shkruar për ta paraqitur provimin”.

Në librin tjetër të paraqitjes së provimeve për gjykatës për kundërvajtje, me numër të protokollit 02/152-2 për vitin 1989/90, të sekuestruar dhe prezantuar si provë nga Policia, në numrin rendor 5, shkruan se Zimer Krasniqi nga Prishtina më datën 11 janar 1991 e ka paraqitur provimin për gjykatës për kundërvajtje. Prokurori Munishi, ka konstatuar se ky emër i takon Zymer Krasniqit nga Deçani edhe pse aty shkruan Zimer Krasniqi nga Prishtina.

Tutje, prokurori Munishi vendos se, fakti i nxjerrjes së vërtetimit për punën praktikë një vjeçare më 12 tetor 1990, nga ish-Gjykata Komunale e Kundërvajtjes në Deçan nga Zymer Krasniqi, përputhet me faktin e paraqitjes së provimit për gjykatës për kundërvajtje nga Zimer Krasniqi nga Prishtina me datën 11 janar 1991.

Prokurori Munishi ka vendosur se, “duket se ky gabim është vërejtur me datë 11.01.1991 nga ana e referentit që ka bërë përmirësimin me korrektor, ashtu që z. Krasniqi e kanë regjistruar në mënyrë të drejtë në librin e paraqitjes së provimit për gjyqtarë për kundërvajtje me numrin rendor 5 e cila mban datën 11.01.1991 ndërsa në vend të tij në librin për dhënie të provimit të judikaturës kanë regjistruar atëkohë kandidatin Aleksandër Lumezi.” (faqe 12 e AKtvendimit).

Si ka mundësi që kanë ndodhur gjithë këto gabime në vazhdim:

- Si ka mundësi që Zymer Krasniqi, i cili më 12 tetor 1990 e kishte nxjerrë vërtetimin për ta paraqitur provimin dhe që figuron se pas 5 dite e ka regjistruar, respektivisht më 17 tetor 1990 (siç edhe përputhet me deklaratën e tij dhënë në polici) të jetë regjistruar gabimisht dhe të jetë kuptuar pas potthujse tre muajve, përkatësisht më 11 janar 1991?
- Nëse është kuptuar se gabimisht është regjistruar Zymer Krasniqi nga Deçani në një libër tjetër, si ka mundësi që në librin tjetër shkruhet Zimer Krasniqi nga Prishtina? A është fjala për të njëjtin person? Si e ka vërtetuar këtë prokurori Munishi?
- Nëse ka ndodhur ky gabim në regjistrim më 17 tetor 1990 dhe është kuptuar më 11 janar 1991 ku më pas është përmirësuar Zymer Krasniqi, atëherë si ka mundësi që Aleksandër Lumezi është shkruar sërish në dy libra të paraqitjes së provimeve? Pse Zymer Krasniqi është mbuluar me llak dhe mbi te në librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës është shkruar Aleksandër Lumezi dhe në të njëjtën kohë Aleksandër

Lumezi është regjistruar se e ka paraqitur edhe provimin profesional dhe atë me datë 9 janar 1991?

- Nëse është gjetur njëherë gabimi se Zymer Krasniqi është regjistruar gabimisht në vend të Aleksandër Lumezit në librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës, pse atëherë është regjistruar edhe në librin e paraqitjes së provimit profesional me 9 janar 1991?
- Pyetje logjike që mbështetet në ndërhyrjet që thuhet se janë bërë retroaktivisht në dosjen e Lumezit. Kur është kuptuar se në Zymer Krasniqi është shkruar gabimisht në librin e paraqitjes së provimit të jurisprudencës dhe mbi të është përmirësuar retroaktivisht Aleksandër Lumezi, atëherë si ka mundësi që kandidati Zymer Krasniqi nuk është regjistruar me 17 tetor 1990 në librin e provimit për gjykatës për kundërvajtje (sikurse pretendohet se ka ndodhur me Lumezin) por është regjistruar me datën 11 janar 1991?
- Si janë vërtetuar këto nga prokurori Munishi për të cilat ka vendosur këtë lidhje interpretim?

9) Dëshmitari Betim Shala

Me datë 01.11.2017, nëcilësi të dëshmitarit është intervistuar Betim Shala, i cili ka deklaruar “provimin e Judikaturës e kam përfunduar në vitin 1991, kam mbetur në riprovim në fund të vitit 1990, Aleksandër Lumezi nuk ka qenë në provim, ndërkaq në afatin e dytë të mbajtur në shkurt të vitit 1991, nuk më kujtohet saktë, por ndoshta edhe ka qenë në këtë afat, është shumë e mundur të ketë qenë.

“Unë personalisht nuk mundem ta di saktë por më kujtohet shumë mirë në atë kohë në vitin 1991 unë kam punuar në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, ndërkaq Aleksandër Lumezi, ka qenë i punësuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, si praktikant dhe një ditë gjatë pauzës në viti 1991, më ka thirrë Aleksandër Lumezi dhe kemi dalur për mëngjes, dhe nuk më kujtohet se kush ka qenë me ne të dy dhe kemi shkuar në Qebabtoren Sarajava, më ka thënë Aleksandri, **“zgjedh çka të duash për mëngjes, se unë po qarosi, pasi e kam dhënë Provimin e Jurisprudencës”**, si detaj që krejt ketë ngjarje e mbaj mend shumë mirë është një fakt, që më ka pasë lënë përshtypje nga ana e tij, është se pasi që zgjedha çka du me hangar për mëngjes, ai më tha po **“marrim edhe nga një copë djath”** e unë deri atëherë kurrë qebapët me djathë nuk i kam ngrenë”, ka thënë dëshmitari Betim Shala.

Në pyetjen: a i keni dhënë ju leje qoftë me verbale apo me shkrim Enver Hasanit, që ai ta shikoj ndonjë dosje tuaj në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Dëshmitari u përgjigj: “Enver Hasani, asnjëherë nuk ka kërkuar leje nga unë dhe asnjëherë nuk e kemi diskutuar në lidhje me lejen e tillë. Unë nuk kam pas asnjë interes juridik apo personal që së pari vet të kërkoj dosjen, e lere më që të kërkoj nga ai, mendoj në Enver Hasanin, që të hulumton dosjen e time nga provimi i Judikaturës. Mirëpo edhe nëse kisha pas ndonjë interes do ta kisha bërë vetë këtë hulumtim, apo do ta kisha angazhuar ndonjë shok-avokat, e assesi Enver Hasanin”. (faqe 5 e Aktvendimit)

IKD: Dëshmia e Betim Shalës është në tërësi jorelevante për zbardhjen e të vërtetës, duke marrë parasysh përmbajtjen e deklaratës së tij. Dëshmitari Shala askund nuk ka dëshmuar se

Aleksandër Lumezi ka hyrë në provim të jurisprudencës së bashku me të. Shala ka supozuar dhe poashtu ka kujtuar qarrosjen me qebapë dhe djathë me rastin, e siç e kujton ai, dhënies së provimit të jurisprudencës nga Aleksandër Lumezi.

Duke u bazuar në standardet e drejtësisë dhe procedurës penale, supozimet nuk kanë vlerë në një procedurë penale.

Çështje në tërësi jorelevante për objektin e hetimit. Sidoqoftë, dokumentet në Arkivin e Kosovës, sipas Ligjit mbi Arkivin Shtetëror janë interes publik dhe të njëjtat mund të përdoren për qëllime hulumtimi, profesionale, apo qëllime tjera. Pra, nuk kërkohet leje nga persona të veçantë për hulumtuar materialin, i cili nuk ka vlerë të veçantë dhe nuk është sekret.

Betim Shala i cili tash ushtron profesionin e avokatit, ka bashkëshorten prokurore në Prokurorinë Themelore të Prishtinës.

10) Dëshmitari Riza Smaka

Me datë 02.11.2017 është intervistuar dëshmitari Riza Smaka, i cili ka deklaruar:

“Në vitin 2000, kam qenë Koordinator i Këshillit për Rekrutimin e kandidatëve për prokurorë dhe gjykatës, i cili ka qenë në kuadër të UNMIK-ut dhe jam emëruar si koordinator nga Bernard Kushner.

Unë kisha për detyrë përcaktimin e kriterëve për konkursin publik për kandidatët për prokurorë dhe gjykatës si dhe realizimi i konkursit duke e përfshirë propozimin e kandidatëve dhe kandidatëve. Emërimin e ka bërë dr. Bernard Kushner. Më kujtohet se sipas propozimit tim këshilli i ka pas përcaktuar anëtarët e vet për intervistimet nëpër qytete të Kosovës në përshtatje me afinitetet e intervistuesve. Për Prishtinë dhe rajonin e Prishtinës, këshilli e ka pas emëruar Adil Fetahun, bashkë me dy anëtarë të jashtëm, një nga Finlanda tjetri nga SHBA-ja. Për provimin e Aleksandëer Lumezit, plotësisht është i informuar dhe ka shënime zyrtare zotëri Adil Fetahu, ngase ai me dy kolegët e tjerë e ka pas bërë intervistimin gojor të Aleksander Lumezi. Mua sa më kujtohet zotëri Aleksander Lumezi në atë etape nuk e ka pasur Çertifikatën e Judikaturës.

Megjithatë, **unë shprehi dyshime** përkitazi kësaj rrethane ngase ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk i kam shënime zyrtare, as që i kam pas marrë me veti. Rrethana se Aleksandër Lumezi ka qenë emëruar Zëvendës Prokuror Komunal në Prishtinë nga dr.Kushner, **më bën edhe me tepër të luhatsëm përkitazi me faktin se zotëri Lumezi në atë etapë e ka pas apo nuk e ka pas certifikatën e Judikaturës.** Në këtë kontekst theksoj se relacionet personale me zotëri Aleksander Lumezi kurdoherë i kam pasur normale dhe njerëzore.

Unë në mendjen time mjegullisht me kujtohet nga puna e komisionit se Aleksander Lumezi nuk e posedon Provimin e Judikaturës por nuk jam i sigurtë për këtë. Unë e kam thirrë sot Adilin, sepse nuk kam qenë i sigurtë nëse Aleksandër Lumezi, e ka të kryer Provimin e Judikaturës dhe e kam thirrë që të marrë informatat më të sigurta për çështjen. Në atë kohë ka pasur shumë kandidat që nuk kanë pasur provimin e Judikaturës, si pasoj e mosmbajtjes së provimit për 10 vite. Këta kandidat nuk i kemi pranuar”. (faqe 6 të Aktvendimit)

IKD: Profesor Dr. Riza Smaka, ka deklaruar se sa i kujtohet, Aleksandër Lumezi në atë etapë nuk e ka pasur provimin e judikaturës. Profesor Dr. Smaka, po ashtu deklaroi se më shumë informata lidhur me këtë çështje ka Adil Fetahu, autor i dhjetëra librave lidhur me sistemin e drejtësisë në Kosovë, dhe njohës i mirë i rrethanave dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i procesit të emërimit të prokurorëve dhe gjykatësve në vitin 1999 dhe 2000 në Kosovë.

Smaka ka deklaruar se Adil Fetahu ka shënime zyrtare lidhur me procesin e emërimit të prokurorëve dhe gjykatësve në vitin 1999 dhe 2000.

Prova më e rëndësishme në këtë rast është procesverbali i hartuar nga Adil Fetahu dhe i miratuar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të emëruar nga PSSP, Bernard Kushner. Procesverbal ky i hartuar dhe miratuar në vitin 1999 dhe 2000.

Procesverbali i këtij viti është prova materiale më e rëndësishme lidhur me zbardhjen e të vërtetës. Shënimet në këtë procesverbal i takojnë vitit 1999 dhe 2000, ku janë të regjistruar të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për prokuror dhe gjykatës, përfshirë të dhëna lidhur me edukimin, përvojën e punës dhe nëse të njëjtit kandidatë kishin deklaruar se e kanë apo nuk e kanë provimin e jurisprudencës. Aleksandër Lumezi në këtë procesverbal nuk ka paraqitur provim të Jurisprudencës.

Pyetjet që shtrohen lidhur me këtë dëshmi janë:

- Prokurori Munishi asnjëherë nuk e ka hetuar këtë rrethanë, dhe gjatë marrjes në pyetje të Aleksandër Lumezit, sipas Aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal, nuk rezultoi se i ka parashtruar pyetjen bazike, nëse Aleksandër Lumezi kur kishte aplikuar për prokuror dhe gjykatës pranë Komisionit në vitin 1999 dhe 2000, pse kishte deklaruar sipas procesverbalit dhe dëshmitarëve të gjallë, se nuk e ka provimin e jurisprudencës?
- Nëse e ka pasur provimin, pse nuk e ka paraqitur para komisionit? Në cilin konkurs kishte konkurruar dhe si ishte dekretuar nga Bernard Kushner?

Deklarata e Riza Smakës, në pjesën e parë i njëjti në asnjë moment nuk deklaroi se Aleksandër Lumezi e ka dhënë provimin e jurisprudencës. Në pjesën e dytë, flet për një rrethanë që ka ndodhur para 16 apo 17 viteve, prapë dyshimi i tij shkon drejt asaj se Lumezi nuk e posedon provimin, por nuk është i sigurt për këtë, pasi i është prezantuar dekreti i Bernard Kushnerit për Aleksandër Lumezin në pozitën e zëvendësprokurorit.

Pas hrdhjes së kallëzimit penal nga prokurori Munishi, Riza Smaka ka deklaruar se qëndron prapa deklaratës së tij se kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi, vetë kishte deklaruar se nuk e kishte të dhënë provimin e judikaturës në 2000 dhe deklarimin e tij e mbështet edhe në procesverbalin e Komisionit, të cilin prokuroria nuk e ka marrë fare parasysh dhe nuk e ka përmendur askund në aktvendimin e saj.

Procesverbali i Komisionit është prova materiale më e rëndësishme lidhur me zbardhjen e të vërtetës, në të cilën janë evidentuar shënimet e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar për prokuror dhe gjykatës.

11) Dëshmitari Adil Fetahu

Me datë 09.11.2017, në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar Adil Fetahu, i cili ka deklaruar:

Nga shtatori 1999 deri dhjetor 2000 kam qenë anëtarë i komisioni gjyqësor dhe prokurorial të UNMIKU-ut, pastaj kam qenë i papunë deri në vitin 2003, kur jam punësuar në institutin privat për ekonomi, ku kam punuar deri në nëntor 2004, dhe prej asaj date jam pensionuar dhe nuk kam punuar.

Detyrë e jona ka qenë që të mbledhin dokumentet e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar për gjyqtarë dhe prokurorë në tërë Kosovën. Konkursët i ka shpallë OSCE-ja, dhe i ka mbledhë dokumentet nga aplikantët, dhe na i ka dorëzuar neve komisionit për ti verifikuar dokumentacionet dhe aplikacionet të cilat i kanë dorëzuar kandidatët, komisioni me ka caktuar mua, Anti Ruocsavalin nga Finlanda dhe Pamela Fahei, e cila ka qenë nga SHBA-ja, në nën komisionin për regjionin e Prishtinës, ku detyrë e imja ishte që ti kontrolloj aplikacionet e aplikantëve, ta bëj regjistrin dhe të ja paraqes komisioni se çka kanë dorëzuar aplikantët.

Me këtë rast unë me datat 8,9,13,20 dhe 21 mars të vitit 2000, i kam lexuar dhe kontrolluar detajisht aplikacionet e 305 kandidatëve të cilët kanë konkurruar për gjykatës, prokurorë apo Gjykatës për Kundërvajtje (kjo është e evidentuar në raportin me titull vërejtje hyrëse), me këtë rast unë kam përpiluar një raport për komisionin në të cilin i kam listuar të gjithë kandidatët sipas gjetjeve të mia në aplikacion dhe dokumente. Pastaj, unë këtë raport ja kam dorëzuar komisionit i cili i ka terminë për intervistimin e kandidatëve.

Pastaj, nënkomisioni i ka intervistuar kandidatët në lokalet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, pas intervistimit, nënkomisioni ka përpiluar një raport, listë lidhur me kandidatët të cilët kemi menduar se i plotësojnë kriteret dhe kushtet e konkursit dhe këtë listë ja kemi dorëzuar komisionit i cili pastaj i ka përpiluar listën dhe i ka propozuar

Bernard Kouchnerit kandidatët për emërim në pozitat e gjyqtarit, prokurorit dhe gjyqtarit për kundërvajtje.

Për të qenë më i saktë në këtë pyetje, kësaj deklarate ia bashkangjes një kopje të procesverbalit të mbledhjes së komisionit të mbajtur të hënën më 04 shtator 2000, i cili i përmban të gjithë emrat e anëtarëve të komisionit.

Në pyetjen se pse disa kandidatë që kanë punuar si Gjykatës Komunal, Gjykatës në Gjykatën e Qarkut, Gjykatës në Gjykatën Supreme dhe Avokat, më shumë se 10 apo 20 vite, por që nuk e kanë evidentuar se kanë të dhën provimin e Judikaturës.

Dëshmitari u përgjigj: “Kjo nënkupton që ai kandidatë ose nuk e ka evidentuar në aplikacion ose nuk ia ka bashkangjitur kopjen e certifikatës së provimit të Judikaturës.

Në pyetjen: A do të thotë kjo që kandidati nuk e ka pasë të kryer provimin e Judikaturës?

Dëshmitari u përgjigj: “ Jo nuk do të thotë asesi, sepse ai ka punuar një kohë të gjatë si gjyqtarë dhe nuk ka mundur për të punuar pa e pasë provimin e kryer, këtë e kam thënë edhe në fletën e parë të raportit që ju keniku thuhet, Vetëm 88 kandidatë e kishin shkruar në aplikacion se e kanë dhënë provimin e jurisprudencës ose atë profesional apo që të dyja rrallë ndonjë kandidat ia ka bashkëngjitur aplikacionit certifikatën e provimit të dhënë mirëpo është një numër i madh i kandidatëve të cilët kanë punuar kohë të gjatë në detyrën e gjykatësit apo prokurorit, që do të thotë se ata e kanë provimin e dhënë, por që në aplikacion nuk e kanë shkruar për shkak se në rubrikat e aplikacionit nuk ekziston kërkesë recidive për këtë, prandaj në intervista duhet të ftohen të gjithë ata kandidatë për të cilët nuk dihet me siguri se a e kanë provimin të dhënë apo jo”.

Në pyetjen: Në medime publike para gazetarëve ju keni deklaruar se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës. Ke thënë se personalisht i ke mbajtur shënimet dhe e ke pyetur Lumezin, icili ka deklaruar se nuk e ka provimin e jurisprudencës.

Dëshmitari u përgjigj: “ Unë nuk kam deklaruar kështu, por kam deklaruar se ai me rastin e dorëzimit të aplikacionit të dokumenteve të bashkëngjitura nuk e ka cekë në aplikacion se e ka kryer dhe se nuk ia ka bashkëngjitur kopjen e certifikatës aplikacionit, por kjo nuk nënkupton se e ka sjellë gjatë intervistës, sikurse edhe kandidatët tjerë e kanë sjellë gjatë intervistës”. (faqet 11 dhe 12 të Aktvendimit)

IKD: Adil Fetahu, autor i dhjetëra librave lidhur me sistemin e drejtësisë në Kosovë, dhe njohës i mirë i rrethanave dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i procesit të emërimit të prokurorëve dhe gjykatësve në vitin 1999 dhe 2000 në Kosovë ka dëshmuar lidhur me procesin e emërimit të prokurorëve dhe gjykatësve në vitin 1999 dhe 2000.

Prova më e rëndësishme në këtë rast është procesverbal i hartuar nga Adil Fetahu dhe i miratuar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të emëruar nga PSSP, Bernard Kushner. Procesverbal ky i hartuar dhe miratuar në vitin 1999 dhe 2000.

Gjithçka rreth kësaj pjese të dëshmisë së Adil Fetahut të bazuar në tërësi në procesverbal është shpjeguar në faqet: 22, 23, 24 dhe 25 të këtij raporti.

Pas publikimit të aktvendimit të prokurorit Kujtim Munishi për hrdhjen e kallëzimit penal, në media u raportua se Adil Fetahu i ka ndërruar deklaratat. Këtë gjë Fetahu e ka mohuar kategorikisht, duke deklaruar se gjithçka që ka deklaruar në intervistë për “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavision si dhe në polici, bazohet ekskluzivisht në procesverbalin e përgatitur në vitin 2000. Ai ka thënë se qëndron prapa çdo shkronje që e ka shkruar në procesverbal dhe që e ka deklaruar publikisht.

Procesverbalet e Adil Fetahut janë mbështetur në tërësi si vërteta edhe nga Riza Smaka, Shaban Kajtazi, Ragip Halili dhe Bajram Krasniqi. Pesë anëtarë të këtij Komisioni Konsultativ Juridik vërtetojnë procesverbalet në të cilat është evidentuar se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës në vitin 2000.

12) Dëshmitari Enver Hasani

Me datë 06.11.2017 është intervistuar Enver Hasani, në cilësi të dëshmitarit, i cili ka deklaruar: “qëndroj mbrapa deklaratës se dhënë në media me titull “ MBI DOSJEN E FALSIFIKUAR , DOSJA “02 Broj 152-1-217/90, Pristina, 27.02.1991 god.”, QE KA TË BËJË MË PROVIMIN E JURISPRUDENCËS SË ALEKSANDËR LUMEZIT”, raport ky i cili ekziston në gjuhën shqipe dhe angleze , të cilin ia kam dërguar shteteve të QUINTIT dhe gjitha mediave. (Aktvendimi, faqe 7)

IKD: Përkundër faktit se Enver Hasani para Prokurorit të Shtetit dhe Policisë ka deklaruar se qëndron prapa pohimeve të tij lidhur me falsifikimin e provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurori Munishi në bazë aktvendimit lidhur me hedhjen e kallëzimit penal nuk ka ndërmarr asnjë veprim për të hetuar këto dyshime të ngritura në publik. Prokurori Munishi asnjëherë nuk ka zhvilluar hetime lidhur me veprën penale nga neni 434 paragrafi 2, të ngritura publikisht nga Enver Hasani.

I tërë fokusi i prokurorit dhe autorizimeve të dhëna policisë është drejtuar lidhur me hetimet për një veprë penale që ka qenë e parashkruar, pra ka hetuar vetëm sa i përket dyshimeve për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar” nga neni 434 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kryesi apo kryesit potencial të kësaj veprë penale sipas Kodit Penal aktual dënohen “me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.” Sipas paragrafit 1 të këtij neni, vepra penale ekziston kur personi zyrtar, në dokumentin zyrtar a afarist, në regjistër apo shkresë shënon të dhëna të rreme ose nuk i shënon të dhënat e rëndësishme, ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën që përmban të dhëna të rreme, ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin po shkresës së tillë me përmbajtje të rreme. Duke u bazuar në elaborimin më lartë, konsumimi i veprës penale sipas paragrafit 1 të nenit 434 të Kodit Penal të Kosovës, mund të kryhet vetëm nga personat përgjegjës që kanë qenë të autorizuar si persona zyrtar në Sekretariatit Krahinor të Judikaturës. Kryesi apo kryesit potencial të kësaj veprë penale sipas Kodit Penal aktual dënohen “me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.” Të gjitha veprimet e Prokurorisë dhe Policisë, sipas autorizimeve të dhëna nga Prokurori Munishi, janë ndërmarr në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, pasi në rastin konkret ka ardhë deri te parashkrimi i ndjekjes penale lidhur me hetimet e autorizuar nga Prokurori Kujtim Munishi.

13) Dëshmitari Aleksandër Lumezi

Me datë 07.11.2017, është intervistuar dëshmitari Aleksandër Lumezi, i cili ka deklaruar:

“Provimin e judikaturës e kam paraqitur diku në fund të vitit 1990, nuk më kujtohet se cili person ka qenë por me kujtohet se e kam dorëzuar në Sekretariatit Krahinor të atëhershëm për Judikaturë dhe Administratë. Në mesin e dokumenteve, aty kam paraqitë vërtetimin që e kam stazhin e praktikantit, vërtetimin që nuk jam nën hetime, kopje të diplomës së fakultetit, me sa më duket kanë qenë krejt dhe nuk me kujtohet diçka tjetër sepse ka kaluar një kohë e gjatë. Me aq sa më kujtohet diku në shkurt të vitit 1991 kam hyrë në provim për herë të parë dhe fillimisht kemi pas provimin me shkrim nga e drejta penale dhe civile, ka qenë kusht për tu dhënë këto dy provime për të vazhduar me provimin me gojë, pastaj provimin me gojë, pas një jave me 25 dhe me 26 shkurt 1991 është mbajtur provimi me gojë.

Unë kam kërkuar publikisht por edhe nga Kryeprokurori i EULEXI-it, për shkak të shmangies të paanshmërisë ta marrin këtë lëndë, në bazë të nenit 7A, të ligjit për vazhdimin e Misionit të EULEX-it në Kosovë, apo që të njëjtën lëndë ta monitoroj EULEX-i. (faqe 8 të Aktvendimit)

IKD: Deklarata e Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, e cituar në aktvendimin e prokurorit Kujtim Munishi është në tërësi deklaratë kundërthënëse me provat dhe dëshmitë e siguruara deri më tash. Deklarata e Lumezit bie në kundërshtim edhe me vetë provat e ofruara për publikun.

Fillimisht, deklarata e Lumezit nuk përputhet me dosjen e tij personale. Askund në dosjen personale nuk ka vërtetim të gjykatës, se e ka përfunduar punën praktike një vjeçare me qëllim që ta paraqesë provimin e jurisprudencës.

Sipas procesverbalit të provimit të Aleksandër Lumezit, rezulton se ai ju ka nënshtruar provimit me shkrim më 25 dhe 26 shkurt 1991, ndërsa më gojë ka hyrë më 24 dhe 26 prill 1991. Ndërsa sipas certifikatës rezulton se e ka kryer provimin më 25 prill 1991.

Deklarata e Lumezit dhënë para Munishit, bie në kundërshtim me procesverbalin e provimit, sepse Lumezi deklaroi se më 25 dhe 26 është mbajtur provimi me shkrim dhe pas një jave është pyetur me gojë, pra provimin me gojë është dashur ta përfundojë në fillim të muajit mars 1991. Por, në procesverbal shkruan se provimit me gojë ju ka nënshtruar më 24 dhe 26 prill 1991, pra pas dy muajve e jo pas një jave siç ka deklaruar.

Prokurori Munishi ka intervistuar eprorin e tij Aleksandër Lumezi në cilësinë e dëshmitarit. Duke pasur parasysh dyshimet e ngritura, provat e siguruara dhe dëshmitarët e gjallë, rezulton se teknikat e marrjes në pyetje në këtë rast nga prokurori Munishi janë të nivelit në mes të vartësit dhe shefit të tij.

Lumezi nuk rezulton se është pyetur dhe ka dhënë përgjigje në çështjet kryesore për të cilat janë ngritur dyshime. Ndër shumë prej këtyre pyetjeve që kërkojnë përgjigje, publiku pret përgjigje se pse Lumezi në vitin 2000 kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror kishte deklaruar se nuk e ka provimin e jurisprudencës, gjë e cila ishte evidentuar në procesverbal? Në këtë pjesë të deklaratës së Lumezit, Kryeprokurori e ka informuar vartësin e tij Kujtim Munishin se ka kërkuar nga EULEX-i që të marrin këtë lëndë, për të shmangur paanshmërinë në hetimin e këtij rasti.

EULEX nuk e ka marrë këtë rast për ta hetuar, por ka deklaruar se rasti është monitoruar nga prokurorja ndërkombëtare.

Ndërkohë, hetimet në këtë rast janë udhëhequr nga prokurori Kujtim Munishi. Munishi vetëm dy vjet e gjysmë pasi ishte bërë pjesë e sistemit Prokurorial të Kosovës, ka arritur të transferohet nga Prokuroria Themelore e Gjilanit, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit me vendim të nënshkruar nga kryeprokurori Aleksandër Lumezi, të datës 28 prill 2015. Sipas vendimit, Kujtim Munishit, prokuror në Prokurorinë Themelore në Gjilan, i janë deleguar kompetenca të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Përveç kompetencave që Munishi do t'i kishte si prokuror i Gjilanit, ai do të ushtronte edhe funksione të tjera që hyjnë në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, duke përfshirë: hartimin e raporteve dhe dokumenteve të tjera me shkrim.

Munishi është caktuar nga Kryeprokurori Lumezi edhe në Komisionin për përcjelljen ditore të mediave dhe verifikimin e pretendimeve të rasteve të supozuara të krimit të organizuar dhe korrupsionit, prej të cilës pozitë edhe e ka iniciuar rastin për të zhvilluar hetim parapenal për dosjen e manipuluar të Aleksandër Lumezit.

Bazuar në Ligjin për Prokurorinë e Shtetit të vitit 2010, i cili ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit, që është data, 28 prill 2015, neni 20, pika 1.4. qartëson që për ta ushtruar funksionin e prokurorit pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kandidati duhet të ketë së paku gjashtë vjet përvojë juridike në të drejtën penale, përfshirë së paku katër vjet përvojë si prokuror. Sipas biografisë së Munishit, ai i është bashkuar sistemit prokurorial të Kosovës më 28 dhjetor 2012, pra përvoja e punës si prokuror ka qenë vetëm 2 vjet e gjysmë.

14) Dëshmia e Timothy J.Baland

Me datë 07.11.2017, i është bërë kërkesë përmes emaili-t Timothy J.Baland-it, që ka punuar në Njësinë e Vlerësimit Profesional për Gjyqtar dhe Prokuror, në vitin 2009, për tu përgjigjur në disa pyetje specifike lidhur me vlerësimin e kandidatëve.

Me datë 08.11.2017, Timothy J.Baland është përgjigjur përmes imellit dhe ka thënë:

“Si përgjigje ndaj pyetjes tuaj me email të datës 7 nëntor 2107, dëshiroj t’ju informoj se çdo diplomë provimi është verifikuar nga departamenti përkatës brenda Ministrisë së Drejtësisë nga juristet në Njësinë e Vlerësimit Profesional të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial.

Në mënyrë të veçantë, stafi i Njësisë së Vlerësimit Profesional, personalisht ka kontrolluar librat dhe regjistrimet relevante, duke përfshirë regjistrin në pajtim dhe mirëmbajtur nga Ministria e Drejtësisë, e atyre që kishin kaluar provimin e jurisprudencës.

Kjo punë është bërë në pajtim me rregullat e brendshme të punës që kanë qeverisur punën e Njësisë së Vlerësimit Profesional. Për informacionin tuaj, unë kam përfshirë një ekstrakt nga ato Rregulla me këtë përgjigje në kërkesën tuaj. Kam përfshirë gjithashtu një ekstrakt nga Raporti Përfundimtar mbi punën e Komisionit në lidhje me detyrat e Njësisë së Vlerësimit Profesional.

Duke pasur parasysh kujdesin me të cilin anëtarët e Njësisë së Vlerësimit Profesional ndërmorën dhe kryenin përgjegjësitë e tyre, është shumë e vështirë për mua të besoj se dikush do të kishte qenë në gjendje të falsifikonte ekzistencën ose vlefshmërinë e diplomës së provimit të jurisprudencës që ishte paraqitur nga një kandidat në lidhje me aplikimin e tij ose të saj.

Megjithëse nuk jam i sigurt për këtë, është e mundur që njësia e verifikimit brenda Këshillit Gjyqësor të Kosovës të ketë disa arkiva nga puna e bërë nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial”. (faqe 8 të Aktvendimit)

IKD: Për dosjen e manipuluar të Lumezit, ekipi i Kohavisionit dhe “Betimi për Drejtësi” kanë pyetur edhe Timothy Baland, Kryetar i Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, i cili kishte zhvilluar procesin e riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë në vitin 2009.

Në një përgjigje përmes postës elektronike, Baland ka thënë se secila diplomë e provimit të jurisprudencës ishte verifikuar në departamentet relevante në Ministrinë e Drejtësisë nga Njësiti për Vlerësimin Profesional të këtij komisioni.

Ai ka theksuar se bazuar në punën e këtij njësiti, e ka të vështirë të besojë se dikush ka pasur mundësi të falsifikojë ekzistimin ose validitetin e diplomës së provimit të jurisprudencës, që ishte dorëzuar nga kandidatët në lidhje me aplikimin në pozitën e tij apo saj.

Dëshmia e kryetarit Baland dëshmon se verifikimi i certifikatave të kandidatëve është bazuar vetëm në librat amzë të Ministrisë së Drejtësisë.

Në këto të fundit, Aleksandër Lumezi figuron se e ka dhënë provimin më 25 prill 1991 në kohën e masave të dhunshme.

Por dyshimet e ngritura në bazë të gjetjeve të hulumtimit bazohen në librin amzë të vitit 1991, i cili ishte mbyllur në mënyrë të kundërligjshme tek në vitin 2000. Mbylljen e librave e ka bërë Sahit Shala pa Kryetarin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Dëshmitari Shala ka thënë se e ka mbyllur librin pa prezencën e Kryetarit në mënyrë që të parandalojë mundësinë e keqpërdorimit të librit, për të shtuar emra të kandidatëve, të cilët nuk e kanë dhënë provimin.

Të dhënat e Lumezit në këtë libër përputhen vetëm me të dhënat e plotësuara mbi dosjen e Zymer Krasniqit dhe askund tjetër.

Derisa deklaratat e Zymer Krasniqit përputhen në tërësi me gjetjet e hulumtimit mbi dosjen e tij personale dhe dosjet në Arkivin e Kosovës.

Ndërkohë, procesverbalet dhe anëtarët e Komisionit Konsultativ Juridik në krye me Riza Smakën kanë deklaruar se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës në vitin 2000 kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror. Këto dosje nuk dihet nëse janë ende tek UNMIK-u, OSBE-ja ose janë transferuar në KPK.

Prokurori Munishi në aktvendim shkruan se ka kërkuar qasje në dosjet e UNMIK-ut dhe OSBE-së, por nuk i ka pritur përgjigjet dhe ka mbyllur hetimin parapenal.

15) Dëshmia e Djorde Aksic

Është siguruar deklarata noteriale e anëtarit të Komisionit të Judikaturës Djorde Aksic, në kohën kur Aleksandër Lumezi i është nënshtruar provimit të judikaturës; deklarata thotë:

Me kërkesë të Aleksandër LUMEZI-it nga Prishtina me përgjegjësi të plotë jap këtë deklaratë: Certifikata mbi kalimin e provimit të Judikaturës me nr.02.br.152-1-1217/90 nga viti 06.05.1991 e cila më është dhënë në shikim, në të cilën thuhet se Aleksandër LUMEZI nga Prishtina me datën 25.04.1991 e ka dhënë provimin e Judikaturës unë e kam nënshkruar. Në bazë të raportit të komisionit për dhënien e provimit të Judikaturës, Sekretari Krahinor për Judikaturë ka qenë i autorizuar për ta nënshkruar Certifikatën për dhënien e provimit të Judikaturës.*(faqe 9 të aktvendimit)*

IKD: Më 1 nëntor 2017, pas publikimit të akuzave se Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi, dyshohet se e ka falsifikuar provimin e jurisprudencës, Lumezi e ka siguruar një vërtetim nga ish-Sekretari Krahinor i Administratës dhe Judikaturës Djordje Aksic, i cili rezulton se është vërtetuar nga noteri në Beograd të Serbisë, përmes të cilit Aksic dëshmon se nënshkrimi i tij në certifikatën e Lumezit është nënshkrimi i tij. Gjatë raportimit të hulumtimit rreth dosjes së manipuluar të Lumezit, ekipi “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavisioni kanë dhënë argumente të dokumentuara dhe dëshmitarë të gjallë që flasin për dosjen e manipuluar dhe deklarinim të vetë të Lumezit se nuk e ka dhënë provimin kur ka konkurruar për gjykatës dhe prokurorë menjëherë pas luftës. Asnjëherë nuk është kontestuar vërtetësia e nënshkrimit të Djordje Aksiqit.

Ky vërtetim i Aksiqit shërben vetëm si dëshmi e autencitetit të nënshkrimit që gjendet në certifikatën e Lumezit.

Sipas vërtetimit të lëshuar me kërkesë të Aleksandër Ljumezit, Djordje Aksiq deklaroi me përgjegjësi të plotë se “Certifikatën për dhënien e provimit të judikaturës 02 nr.152-1-1217/90 të datës 06.05.1991, e cila më është dhënë në shikim, në të cilën shkruan se Aleksandër Lumezi nga Prishtina, më dt. 25.04.1991 e ka dhënë provimin e judikaturës, e kam nënshkruar unë”.

Por, hulumtimi dëshmon se certifikata është lëshuar një ditë para se Aleksandër Lumezi ta përfundon provimin e jurisprudencës, që sipas dosjes bazë, rezulton se nuk është kryer me 25, por më 26 prill 1991.

Në këtë vërtetim shkruan se “Sipas raportit të Komisionit për dhënien e provimit të judikaturës, Sekretari Krahinor për judikaturë ka qenë i autorizuar për t’i nënshkruar certifikatat për provimet e judikaturës”.

Ky vërtetim është noterizuar në Beograd të Serbisë. Nënshkrimi është bërë nga praktikantja e autorizuar nga noteri Dejan Radulović. Ai në përmbajtje të këtij dokumenti, deklaroi se nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e këtij dokumenti, por vetëm për formën, për të cilën Aksiq ka deklaruar se nënshkrimi i tij është origjinal në certifikatë.

Gjatë hulumtimit në gazetën zyrtare në Bibliotekën e Kosovës, rezultoi se Djordje Aksic ishte emëruar në pozitën e Sekretarit Krahinor për Jurisprudencë e Administratë të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, gjatë kohës së masave të dhunshme, pas dëbimit të punëtorëve shqiptarë. Emërimi i Aksiqit ishte bërë më 19 korrik 1990 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës Socialiste të Serbisë Zoran Sokolović. Para emërimit në këtë pozitë, Aksiq kishte qenë në pozitën e nënkryetarit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës.

Gjithashtu, ritheksohet se prokurori Munishi këtë provë e ka marr në kundërshtim me ligjin. Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet penale e konsideron të pa pranueshme një dokument gjyqësor, jo gjyqësor që nuk është marr përmes rrugëve diplomatike nga një shtet tjetër. Sido që të jetë, ky dokument ligjërisht është i papranueshëm. Është lëshuar nga një shtet tjetër, dhe nuk ka ardhur përmes rrugëve diplomatike, respektivisht përmes Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

VII. Ndërhyrjet politike dhe paragjykimet në hetimin e dosjes Lumezi

Dyshimet e ngritura në publik se Aleksandër Lumezi e të falsifikuar provimin e jurisprudencës dhe proces i hetimeve parapenale të zhvilluara nga prokurori Kujtim Munishi është përshkruar me paragjykime dhe ndërhyrjenga politika, qeveria dhe vetë sistemi prokurorial.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, kishte propozuar Aleksandër Lumezin për Kryetar të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Në gjithë historikun e këtij Komisioni, figuron se Kryetar i Komisionit ka qenë Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës. Me ngritjen e debatit rreth dyshimeve për falsifikimin e provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezit, ministri Tahiri ka bërë disa deklaratë, duke i paragjykuar hetimet e prokurorisë, se ato, do të përfundojnë për një kohë të shkurtër. Tahiri ka thënë ka kërkuar përfshirjen edhe të ndërkombëtarëve “dhe se shpreson se brenda kësaj jave do të përfundojë ky rast me një hetim të qartë dhe kredibil”. Kjo përbën ndërhyrje të politikës dhe ekzekutivit mbi sistemin prokurorial dhe hetimet që janë duke u zhvilluar në këtë rast. Ministri nuk ka kompetenca të ketë asnjë informacion dhe përgjegjësi në proceset hetimore që zhvillohen. Pushtetet janë të ndara dhe duhet të respektohen me përpikëri. Fakti se ministri flet për afate kohore me kompetencë, paraqet ndërhyrje të pastër të politikës në hetime.

Në anën tjetër, Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka paragjykuar në tërësi çdo dyshim të ngritur rreth dosjes së falsifikuar të provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezit. Sipas Këshillit, Lumezi ka kaluar të gjitha filtrat e emërimit dhe poashtu të verifikimit në vitin 2009-2010 nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Faktet e prezantuara Këshilli i ka vlerësuar si përpjekje për të dëmtuar imazhin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe të sistemit prokurorial, prandaj kanë kërkuar nga ata të cilët i kanë ngritur këto dyshime, që të njëjtat t'i tërheqin publikisht.

Në të njëjtën linjë me Këshillin, kanë reaguar Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, e cila ka paragjykuar në tërësi pretendimet e ngritura rreth provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezi. Shoqata ka vlerësuar hulumtimet si tendencë për të zbehur dhe zbrapsur punën e Prokurorëve të Shtetit, duke i quajtur hulumtime të përgatitura dhe të fabrikua. Shoqata ka kërkuar nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare t'i dalin në mbrojtje Prokurorit të Shtetit, duke i ofruar mbështetje të plotë Kryeprokurorit të Shtetit, në punën e tij të suksesshme.

VIII. Monitorimi sipërfaqësor i EULEX-it

Në aktvendimin për hedhjen e kallëzimit penal, Prokurori Munishi ka deklaruar se prokurorja e EULEX-it Eëa Korpi e ka monitoruar rastin ose është informuar lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra nga Prokuroria dhe Policia.

Një përgjigje misionit të EULEX-it për “BetimipërDrejtësi” dhe Kohavision, ky mision ka deklaruar se prokurorja e EULEX-it është e kënaqur se hetimet lidhur me dyshimet për provimin e jurisprudencës të Kryeprokurorit të Shtetit janë udhëhequr në mënyrë të paanshme dhe të pavarur. Prokurorja e EULEX-it është e opinionit se hetuesit policor dhe Prokurori i Shtetit kanë përfunduar hetimet në mënyrë të paanshme dhe të pavarur.

IKD: Përgjigja e misionit të EULEX-it, procesin e monitorimit ia atribuon prokurores Korpi individualisht. Misioni i EULEX-it, nuk deklarohet nëse ky është edhe qëndrim zyrtar i këtij misioni, apo vetëm qëndrim dhe opinion i prokurores Korpi ashtu si janë dhënë përgjigjet e këtij misioni.

“Betimi për Drejtësi” dhe Kohavisioni, ka zhvilluar intervista me pothuajse të gjithë dëshmitarët shqiptarë që janë marrë në pyetje nga prokuroria dhe policia. Pothuajse të gjithë kanë deklaruar se gjatë marrjes në pyetje nuk ka pasur përkthim në gjuhën angleze. Sipas tyre, rrallë ka ndodhur që vetë prokurori Munishi pjesë të dëshmive të tyre i ka përkthyer në gjuhën angleze për prokuroren Korpi.

Ekipi i “BetimipërDrejtësi” dhe Kohavision kanë dërguar këto pyetje misionit të Eulex-it lidhur me monitorimin nga prokurorja Korpi:

- A flet dhe a e kupton gjuhën shqipe apo serbe Prokurorja Korpi?
- Marrja në pyetje e shumicës së dëshmitarëve nuk është kryer në prani të përkthyesit Pasi shumica e dëshmitarëve kanë dhënë se Prokurori Munishi rrallë ka përkthyer disa pyetje për prokuroren Korpi. Ju lutem na konfirmoni nëse kjo ka ndodhur?
- Gjatë procesit të monitorimit, a ka pas prokurorja Korpi qasje në dokumentet, autorizimet, marrjen në pyetje të dëshmitarëve, urdhrat për sekuestrimit e dokumenteve të lëshuara nga prokurori Munishi?
- A ka pas njohuri Prokurorja Korpi se rasti i udhëhequr nga Prokurori Munishi dhe Policia e Kosovës është përqendruar vetëm lidhur me veprën penale sipas nenit 434 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës?
- A ka qenë e informuar Prokurorja Korpi se të gjitha dokumentet janë sekuestruar pa urdhër gjykate?
- Kur prokurorja Korpi, dhe EULEX-i do të publikojnë për publikun raportin lidhur me monitorimin e procesit për hetimet e lartpërmendura?

Në pyetjet e lartpërmendura ky mision në përgjigjen e saj ka thënë se “Prokurori i EULEX-it është i kënaqur se hetimet lidhur me dyshimet për provimin e jurisprudencës të Kryeprokurorit të Shtetit janë udhëhequr në mënyrë të paanshme dhe të pavarur. Prokurori i EULEX-it është i opinionit se hetuesit policorë dhe Prokurori i Shtetit ka përfunduar hetimet në mënyrë të paanshme dhe pavarur.”

Ekipi i emisionit “Betimi për Drejtësi” dhe Kohavision kanë përsëritur pyetjet e njëjta te misioni i EULEX-it, duke kërkuar po ashtu sqarim nëse këto përgjigje janë qëndrim zyrtar i misionit të EULEX-it apo mendime personale të prokurores Korpi. Deri në këtë fazë ende nuk është pranuar përgjigje nga misioni i EULEX-it.

IX. Rekomandimet

Në mënyrë që të ruhet integriteti i sistemit të drejtësisë, përkatësisht sistemit prokurorial, IKD ofron disa rekomandime se si të vepohet në lidhje me rastin e dosjes së manipuluar të Aleksandër Lumezit.

- Dyshimet e ngritura në publik nga denoncimi publik i Enver Hasanit se Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi e ka të falsifikuar provimin e jurisprudencës nuk janë hetuar asnjëherë nga prokurori Kujtim Munishi. Munishi i ka kufizuar hetimet dhe kundërligjshëm ka hetuar veprën e parashkruar penale të përcaktuar në nenin 434 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës. Prokurori Munishi nuk ka zhvilluar hetime për veprën penale të përcaktuar në nenin 434 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës, siç janë ngritur dyshimet në publik ndaj Aleksandër Lumezit. Me qëllim të zbardhjes së të vërtetës dhe zhvillimit të një procesi hetimor të pavarur, paanshëm, të drejtë dhe profesional, rekomandohet që në pajtim me obligimet kushtetuese dhe ligjore këto dyshime të ngritura në publik të hetohen nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.
- Të gjitha kushtet ligjore për hetimin e këtij rasti nga EULEX-i janë të plotësuara. Rekomandohet që hetimi të zhvillohet përmes krijimit të një ekipi të prokurorëve të EULEX-it me prokurorë amerikanë, britanikë dhe gjermanë.
- PSRK rekomandohet të kërkoj ekspertizë të të gjitha dokumenteve të manipuluar me llak dhe të tjera që dyshohet se janë falsifikuar në një nga shtetet e lartpërmendura.
- KPK deri në zbardhjen e këtij rasti në pajtim me ligjin e aplikueshëm të marr masa lidhur me suspendimin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi.
- PSRK të analizoj aktvendimin për hedhjen e kallëzimit penal nga Prokurori Munishi, dhe të hetojë nëse gjatë trajtimit të këtij rasti është zbatuar ligji dhe procedurat sipas legjislacionit në fuqi.
- ZPD të hetoj aktvendimin për hedhjen e kallëzimit penal nga Prokurori Munishi, lidhur me shkeljet disiplinore eventuale. ZPD në shumë raste ka dërguar në KGJK dhe KPK kur prokurorë dhe gjykatës kanë hetuar apo gjykuar raste që kanë qenë të parashkruara, përfshirë raste kur edhe janë shqiptuar masa disiplinore kundër prokurorëve apo gjykatësve.